

# THE KOSOVO BANKER

Korrik 2019 • Numër 15

## PARATHËNIE E KRYETARIT TË RI TË BORDIT TË DREJTORËVE TË SHBK-SË

**Albert Lumezi**

Kryetar i Bordit të Drejtorëve në Shoqatën  
e Bankave të Kosovës **6**

## VLERËSIMI I RREZIKUT TË PPP NË BANKA - NJË MEKANIZËM PËR MENAXHIMIN E RREZIKUT PËR TË PARANDALUAR DHE LUFTUAR PASTRIMIN E PARAVE

**Dr.Sc.Alban HETEMI dhe**

**Dr.Sc.Ozan GÜLHAN**, TEB Bank **8**

## SIGURIMI I RISKUT DHE PAJTUESHMËRISË NË NËN KONTRAKTIMIN (OUTSOURCING) E AKTIVITETEVE NGA RREGULLATORI GJERMAN DHE PERSPEKTIVA E PRAKTIKAVE MË TË MIRA

**Dafina Dobroshi-Kabashi**

ProCredit Bank Kosova **13**

# Drejt standardeve bankare evropiane

Sfidat e sektorit bankar të Kosovës  
në përmbushjen e standardeve  
bankare evropiane

**FOR A**

**DEBT-FREE WORLD**

**FEEL OUR HEARTBEAT**

**TRUST**

**WALK YOUR TALK**

**LOVE TO LEARN**

**STRIVE FOR EXCELLENCE**

**EMBRACE CHANGE**

**SHARE YOUR KNOWLEDGE**

**BE COURAGEOUS**



# PËRMBAJTJA

#KosovoBankingAssociation

#KosovoBankingAssociation

## 05 EDITORIAL

PETRIT BALIJA - KRYESHEF EKZEKUTIV - SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS

## 06 PARATHËNIE

Parathënie e Kryetarit të ri të Bordit të Drejtorëve të SHBK-së - Z. ALBERT LUMEZI - KRYETAR I BORDIT UDHËHEQËS TË NLB-SË

## 07 OPINION

Cilat janë sfidat e sektorit bankar në rrugën e saj drejt standardeve evropiane?

ROBERT WRIGHT - RAIFFEISEN BANK CEO



## 08-22

Vlerësimi i Rrezikut të PPP në banka - Një mekanizëm për menaxhimin e rrezikut për të parandaluar dhe luftuar pastrimin e parave - DR.SC.OZAN GÛLHAN DHE DR.SC.ALBAN HETEMI, TEB BANK

Sigurimi i riskut dhe pajtueshmërisë në nën kontraktimin (outsourcing) e aktiviteteve nga rregullatori gjerman dhe perspektiva e praktikave më të mira - DAFINA DOBROSHI-KABASHI, PROCREDIT BANK KOSOVA

€STR - Algjebra e porsalindur e bankave (The NEWBORN) - BORYANA IVANOVA MUSTAFA, NLB BANK



## 23-33

Transformimi digjital në industrinë bankare - CHRISTOS ELEFTERIADIS, EZOPS

Të drejtat e individëve kundrejt detyrimeve të tyre ndaj kontrollorëve të dhënave personale - KATERINA BOSEVSKA, EOS MATRIX-MAQEDONI, KOSOVË & MAL I ZI

Siguria e përdorimit të kartelave në internet - AKIL NDRENIKA, PAYLINK



## 34-39

### AKTIVITETET NGA SHBK



## 40-42

### BANKAT FUQIZOJNË SHOQËRINË

KËNDI I EKSPERTËVE

SEKTORI FINANCIAR

## THE KOSOVO BANKER

KRYESHEF EKZEKUTIV I SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS DHE KRYEREDAKTOR:  
Z. PETRIT BALIJA

REDAKTOR DHE ZYRTAR PËR KOMUNIKIM:  
Z. ADLUM RAMADANI

BORDI I DREJTORËVE TË SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS

Z. ALBERT LUMEZI

NLB Bank / Kryetar i Bordit të SHBK

Z. ROBERT WRIGHT

Raiffeisen Bank / Zv. Kryetar i Bordit të SHBK

Z. PETRIT BALIJA

Shoqata e Bankave të Kosovës / CEO

Z. ALPER KARAKOÇ

IS Bank

Z. ARTON CELINA

Banka për Biznes

ZNJ. ERIOLA BIBOLLI

ProCredit Bank Kosova

Z. FATOS KRASNIQI

Banka Ekonomike

Z. MERITON SUNDURI

Ziraat Bank

Z. ORCUN OZDEMIR

TEB Bank

Z. SUAT BAKKAL

Banka Kombëtare Tregtare



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) është zëri i industrisë bankare në Republikën e Kosovës. SHBK është përfaqësuese e bankave komerciale të Kosovës, anëtare të SHBK, në lidhje me çështjet sektoriale bankare dhe bashkëpunon me të gjitha autoritetet përfshirë Kuvendin e Republikës së Kosovës, Qeverinë, Bankën Qendrore, Institucionet Financiare Ndërkombëtare, Mediat, etj, me qëllim mbështetjen e stabilitetit dhe zhvillimit të sektorit bankar në Kosovë.

The Kosovo Banker është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Botohet dy herë në vit (korrik dhe dhjetor), me qëllim të informimit të saktë të publikut lidhur me industrinë bankare në Kosovë. Shoqata e Bankave të Kosovës; Rr. Lidhja e Pejës p.n, Zona Industriale, Prishtinë; 10000. Republika e Kosovës; +381 38 246 171; www.bankassoc-kos.com; contact@bankassoc-kos.com;



# EDITORIAL



**PETRIT BALIJA**

KRYESHEF EKZEKUTIV - SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS

Rruga të cilën ka marrë sektori bankar në Kosovë krahas sfidave, është përplotë potencial, me të cilin shoqërohen edhe mundësitë e shumëta që ofrohen për zhvillim të qëndrueshëm dhe të mirëfilltë. Zhvillimet moderne të sistemit financiar, sistemit të pagesave, potencialit të financimit, përshtatshmërisë së reformave ligjore dhe zbatimit institucional janë disa nga elementet që e karakterizojnë procesin e integritit dhe adaptimit të sektorit bankar me atë evropian, duke synuar standardet evropiane, të cilat mund të përmbushen vetëm me angazhim dhe përkushtim maksimal nga sektori bankar në Kosovë.

Pikërisht, me qëllim të analizimit, krahasimit dhe krijimit të një pasqyre të qartë të gjendjes aktuale dhe sfidave të sektorit bankar në Kosovë, është përcaktuar edhe tema e këtij edicioni të “The Kosovo Banker”, i cili do të shërbejë si burim referimi për audiencën e sektorit bankar, që të njihet nga afër me sfidat, mundësitë dhe vizionin drejt standardeve bankare evropiane.

Përmbushja e standardeve evropiane bankare nga sektori bankar në Kosovë çdo ditë e më shumë po merr formë, ndërsa zhvillimet që po e ndjekin këtë sektor po krijojnë mundësinë e qartë për të synuar standardet evropiane bankare. Reflektimi i këtij sektori mbi tranzicionin bankar në Kosovë, avan-

cimi i shërbimeve dhe adaptimi i reformave ligjore ka hapur mundësinë e krijimit të një etape të re bashkohore me zhvillime të reja, të cilat padyshim janë thelbësore për përmbushjen e standardeve evropiane në sektorin bankar.

Ky edicion, përpos që do të trajtojë tema dhe aspekte të përmbushjes së standardeve

evropiane bankare, do t’i ofrojë lexuesit edhe çasje të re nga këndvështrimi i ekspertëve, të cilët me përvojën e tyre në sektorin bankar, kanë arritur të lënë gjurmë afat-gjate, duke kontribuar drejtpërdrejt në përshejtimin e këtij rrugëtimi, i cili është me plot potencial.





## ALBERT LUMEZI

Kryetar i Bordit të Drejtorëve të SHBK-së

Kryetar i Bordit Udhëheqës të NLB-së

# Parathënie e Kryetarit të ri të Bordit të Drejtorëve të SHBK-së

**P**ërzgjedhja në krye të Shoqatës së Bankave të Kosovës, është nderë dhe njëkohësisht përgjegjësi, për të kontribuar në drejtim të arritjes të synimeve të përbashkëta të sistemit bankar në Kosovë. Artikulimi sa më i drejtë i potencialit të sistemit bankar në ekonominë e vendit me qëllim të mbështetjes financiare dhe ngritjes së kapaciteteve financiare në përgjithësi do të jetë një nga qëllimet kryesore të Shoqatës së Bankave dhe Bordit të saj të cilën do të drejtoj në këtë mandat.

Ambienti makroekonomik në Kosovë gjatë vitit 2018 ka mbetur i qëndrueshëm, nxitur pjesërisht nga remitencat e larta nga diaspora, investimet publike në infrastrukturë, dhe rritjes së konsumit vendor. Sfidat kryesore për shoqërinë kosovare dhe përmirësimin e ambientit makroekonomik edhe me tutje mbesin niveli i lartë i papunësisë, struktura e pavolitshme ekonomike e shfaqur sidomos me deficit të lartë tregtar dhe të bilancit të pagesave, niveli modest i investimeve të huaja direkte si dhe niveli i ulët i sundimit të ligjit me theks të veçantë në efikasitetin e sistemit gjyqësor.

Kjoja e ambientit ekonomik nga bankat ka ndihmuar drejtpërdrejtë në krijimin e një perceptimi real për rrezikun e asociuar me investimet e bëra duke mundësuar ofrimin e shërbimeve adekuate financiare të përshtatshme dhe kualitative si dhe me norma më të favorshme të interesit.

Treguesit kryesor financiarë të sektorit bankar vazhdojnë të shfaqin shkallën e lartë të qëndrueshmërisë që ka ky sektor. Përmirësimi i kushteve të ofertës kredito-

re, së bashku me rritjen e kërkesës për kredi, bënë që kreditimi bankar të përshpejtojë ritmin e rritjes. Rritja e depozitave, kryesisht të mbledhura brenda vendit, vazhdon të shërbejë si burim i qëndrueshëm financimi për aktivitetin e sektorit bankar. Normat e interesit në kredi vazhduan të zvogëlohen, duke reflektuar përmirësimet në ambientin e përgjithshëm afarist në vend, rritjen e konkurrencës dhe përmirësimin e efikasitetit të bankave.



Shoqata e Bankave të Kosovës do të vazhdojë të kontribuojë pozitivisht në ambientin e të bërit biznes në Kosovë duke shërbyer si aks kompetencash dhe përçues i potencialit të sistemit bankar në ekonominë e vendit, si njëri nga mbështetësit kryesor të zhvillimit ekonomik.

Si reflektim i dinamikave teknologjike dhe ndikimit të tyre në sferën financiare, sistemi bankar në Kosovë ka arritur të bëjë ndryshime kualitative në ofrimin e shërbimeve elektronike në nivel të vendit. Rrjedhimisht me qëllim të plotësimit të kërkesave financiarë të tregut dhe me qëllim të avancimit të tregut bankar në Kosovë, bankat kanë bërë zhvillime të vazhdueshme inovative të produkteve të ndryshme bankare. Kësaj situate stabile i ka kontribuar edhe avancimi i të gjitha funksioneve të BQK-së duke arritur t'i sigurojë vendit një sistem financiar stabil dhe në funksion të zhvillimit ekonomik,

si dhe shërbime efikase për publikun. Korniza rregullative për sektorin financiar dhe kapacitetet mbikëqyrëse të saj vazhduan të avancohen edhe më tutje, duke kontribuar kështu në zhvillimin dhe stabilitetin e sistemit financiar.

Prandaj, Shoqata e Bankave të Kosovës duke bashkëpunuar me të gjithë akterët e involvuar do të vazhdojë të kontribuojë në ngritjen e kapaciteteve, avancimin e kornizës ligjore bankare si dhe ndikimit pozitiv në zhvillimin ekonomik të vendit.

**ROBERT WRIGHT**

Nënkryetar i Bordit të Drejtorëve të SHBK-së  
Raiffeisen Bank Kosovo - CEO

# Cilat janë sfidat e sektorit bankar në rrugën e saj drejt standarteve evropiane?

Dita kur Kosova do të bëhet anëtare e BE-së mund të jetë ende mjaft larg, por është e rëndësishme që sektori bankar të veprojë sa më afër standardeve të BE-së, sa më shpejt që të jetë e mundur. Më konkretisht, këtu po i referohem veprimit në përputhje me rregulloret, parimet dhe standardet e organeve qeverisëse me bazë në BE, si Banka Qendrore Evropiane, Autoriteti Bankar Evropian dhe Banka për Ujdi Ndërkombëtare.

Shumë banka në Kosovë janë filiale të grupeve bankare me bazë në BE, për shembull Raiffeisen Bank është pjesë e Raiffeisen Bank International me seli në Austri, dhe NLB është filiale e Nova Ljubljanska Banka, zyra kryesore e së cilës është në Slloveni, dhe për këtë arsye inkurajohen ose kërkohet që të veprojnë në përputhje me standardet e BE-së në Kosovë edhe pse vendi nuk është anëtar i BE-së.

Respektimi i plotë i fushëveprimit dhe kompleksitetit të rregullave bankare dhe kërkesave mbikëqyrëse të BE-së është sfida e madhe dhe përfshin fusha të tilla si menaxhimi i riskut, shërbimet financiare për klientët, shërbimet e pagesave dhe standardet e raportimit dhe auditimit bankar. Disa nga këto rregullore, siç janë Basel II, Basel III, MiFID II, PSD2, IFRS9, etj., tashmë janë në zhvillim e sipër ose në listën e zhvillimit për bankat e Kosovës, dhe Banka Qendrore dhe institucionet e tjera po ndihmojnë industrinë bankare në këto zhvillime.

Sektori bankar i Kosovës tashmë ka dëshmuar se mund të përshtatet dhe të ndryshojë shpejt dhe në mënyrë efektive dhe ne kemi arritur në vetëm 15 vite atë që në disa vende të BE-së ka marrë 30 apo më shumë vite për t'u arritur. Për këtë arsye, unë kam besim të plotë se zbatimi i standardeve të BE-së në sektorin bankar të Kosovës do të jetë tregim i ngjashëm suksesi.

Ambicia e sektorit bankar për të vepruar sipas standardeve të BE-së është perspektivë shumë pozitive si për bankat ashtu edhe për klientët e tyre, por rregullimi më i rreptë dhe më i ndërlikuar i përmendur do të ushtrojë presion mbi resurset, kostot dhe efikasitetin operativ të bankave. Megjithatë, krahasuar me barrën e rëndë që kriza financiare ia imponoi njerëzve dhe ekonomisë në mbarë Evropë 10 vjet më parë, besoj se ky është çmim i pranueshëm për t'u paguar.

Përveç sfidave rregullatore, gjithashtu lypsen ndryshime të ndjeshme teknologjike nëse sektori bankar i Kosovës pritet të veprojë në përputhje me standardet e BE-së dhe kjo është përveçem nga transformimi digjital me të cilin industria tashmë është duke u përballur. Bankat

e reja digjitale, të zhdërvjellëta, efikase dhe të uritura që po futen në treg tani paraqesin sfida për bankat ekzistuese në Kosovë dhe bankat duhet të merren me këtë gjë në të njëjtën kohë me evoluimin drejt standardeve bankare të BE-së.

Të gjitha këto zhvillime, investime dhe ndryshime do të pasqyrohen në shpenzimet operative dhe fitimet e bankave dhe do të ushtrojnë presion mbi raportet e performancës, siç janë raporti i kapitalit të nivelit 1 dhe raporti kosto ndaj të ardhurave. Megjithatë, ky skenar potencialisht sfidues nuk është edhe aq sfida për bankat e Kosovës, duke pasur parasysh kriteret e shkëlqyera të performancës së një industrie që është e qëndrueshme, fitimprurëse, e kapitalizuar mirë dhe e suksesshme. Në këtë kontekst nuk ka pasur ndonjëherë moment më të mirë për të zbatuar ndryshimet dhe besoj se përfitimet për industrinë bankare dhe klientët e saj do të ishin shumë pozitive dhe do të justifikonin plotësisht përpjekjet dhe resurset e nevojshme.

Sektori bankar i Kosovës tashmë ka dëshmuar se mund të përshtatet dhe të ndryshojë shpejt dhe në mënyrë efektive dhe ne kemi arritur në vetëm 15 vite atë që në disa vende të BE-së ka marrë 30 apo më shumë vite për t'u arritur. Për këtë arsye, unë kam besim të plotë se zbatimi i standardeve të BE-së në sektorin bankar të Kosovës do të jetë tregim i ngjashëm suksesi.

**DR.SC.ALBAN HETEMI**

Menaxher i Departamentit të PPP dhe Kontrollit të Sanksioneve, TEB

**DR.SC.OZAN GÜLHAN**

Udhëheqës i Divizionit të Pajtueshmërisë, TEB

# Vlerësimi i Rrezikut të PPP në banka - Një mekanizëm për menaxhimin e rrezikut për të parandaluar dhe luftuar pastrimin e parave

## 1 HYRJE

Në ditët e sotme kuadri ligjor për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave është bërë më i përqendruar në rrezik, duke kërkuar që bankat të kuptojnë rreziqet, që mund të ballafaqohen bazuar në modelin dhe strategjinë e tyre të biznesit. Një kornizë e mekanizmit të menaxhimit të rrezikut dhe një mjet i fuqishëm për vlerësimin e rrezikut të Parandalimit të Pastrimit të Parave (PPP) të kësaj kornize është bërë një prioritet kyç.

Ai është njëri nga bazat/ buri- met e skenarëve të rinj, që duhet të projektohen nga bankat për të zvogëluar rreziqet e reja të identifikuarra. Si i tillë, Vlerësimi i Rrezikut të PPP përfshin një matricë për rreziqet e identifikueshme, duke siguruar nivelet më efektive të pajtueshmërisë për PPP dhe aftësinë për të identifikuar, analizuar, raportuar dhe parandaluar pastrimin e parave.

Bankat zbatojnë standardet më të larta, metodat nga praktikat më të mira ndërkombëtare në luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe akteve të tjera të dënueshme me ligj. Punonjësit e bankave janë të përkushtuar t'i përmbahen këtyre stan-



Në bazë të vlerësimit të rrezikut të PPP zhvillohen masa adekuate parandaluese dhe masat aktualisht në fuqi vlerësohen dhe zgjerohen.

dardeve për të shmangur keqpërdorimin e produkteve dhe shërbimeve të bankës për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Për të zvogëluar siç duhet rreziqet që bankat mund t'iu ekspozohen, duhet të kryhet së paku një vlerësim vjetor i rrezikut për PPP. Në bazë të vlerësimit të rrezikut të PPP zhvillohen masa adekuate parandaluese dhe masat aktualisht në fuqi vlerësohen dhe zgjerohen.



## 2

**QËLLIMI I VLERËSIMIT TË RREZIKUT TË PPP**

Qëllimi i vlerësimit është të përcaktojë se çfarë është adekuate në aspektin e masave mbrojtëse visa-a-vis rreziqeve që bankat mund t'iu ekspozohen. Për më tepër, vlerësimi i rrezikut zbaton kërkesat e ligjeve, rregulloreve dhe praktikave e standardeve më të mira ndërkombëtare. Vlerësimi shërben si bazë për qasjen e bazuar në rrezik, siç përcaktohet në Politikat dhe Procedurat e bankave për PPP. Vlerësimi i Rrezikut për PPP shërben si pikënisje për strategjinë e orientuar drejt rrezikut në lidhje me masat monito-

ruese dhe masat mbrojtëse, që duhet të miratohen për të parandaluar pastrimin e parave. Qëllimi i tij është identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve që janë specifike për bankat, duke marrë parasysh gjithashtu rreziqet kyçe që mund të jenë specifike për Kosovën (bazuar në tipologjitë e Njesisë lokale për Inteligjencë Financiare - NjIF të raportuara në raportet vjetore dhe raportet e BE-së për Kosovën). Duke përcjellur planin rreth tablos së rrezikut, masat adekuate zbutëse konceptohen dhe dokumentohen për secilin rrezik brenda fushëveprimit të vlerësimit të rrezikut.

## 3

**PËRMBAJTJA DHE METODOLOGJIA**

Vlerësimi i Rrezikut për PPP paraqet një studim të plotë të situatës në lidhje me ekspozimin ndaj rrezikut të pastrimit të parave në banka. Më pas, ky vlerësim do të identifikojë rrezikun specifik të lidhur me Klientët, Produktet dhe Shërbimet, Vendet dhe Kanalet e Shërbimit. Rreziku i lidhur më pas do të kategorizohet dhe vlerësohet me qëllim që t'i jepet përparësi masave parandaluese përkatëse dhe të zvogëloj të gjitha rreziqet që lidhen me pastrimin e parave.

**RREZIQET E QENËSISHME**

- Klientët
- Produktet dhe shërbimet
- Vendet
- Kanalet

**EFFEKTIVITETI I KONTROLLAVE**

- Qeverisja
- Politikat dhe procedurat
- Njkt/ kujdesi i duhur
- Vlerësime tjera të rreziqeve
- Menaxhimi i informatës
- Ruajtja e të dhënave
- Njësia për ppp
- Raportimi i rad
- Monitorimi dhe kontrollat
- Trajnimet
- Testimi i pavarur (Audit)

**RREZIQET REZIDUALE**

- Veprime strategjike
- Veprime taktike
- Apetiti për rrezik

Figura 1 - Metodologjia e Vlerësimit të Rrezikut (Burimi: the Wolfsberg Group's FAQ on Risk Assessment)

Hapi i parë gjatë kryerjes së Vlerësimit të Rrezikut për PPP duhet të përcaktohet rreziku i qenësishëm dhe ekspozimi ndaj rreziqeve të pastrimit të parave. Rreziqet mund të ndryshojnë nga njëra bankë në tjetrën dhe duhet të përcaktohen në një qasje të bazuar në rrezik dhe është një pikë kyçe për vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut të PPP.

Hapi i dytë është vlerësimi i kontroleve të brendshme / masave mbrojtëse. Në këtë hap vlerësohet efikasiteti i mekanizmit të kontrollit të brendshëm dhe ato

duhet të përcaktohen kundrejt këtyre rreziqeve të identifikuar.

Hapi i tretë është përcaktimi i rrezikut të mbetur (rezidual). Si i tillë, sapo të identifikohen dhe përcaktohen rreziqet e qenësishme si dhe efektiviteti i mekanizmit të kontrollit të brendshëm, mund të përcaktohet rreziku i mbetur/rezidual. Bazuar në rrezikun e mbetur banka mund të zgjerojë masat ekzistuese, që ato kanë në dispozicion ose të pranojnë rreziqe, sipas rastit. Identifikimi i faktorëve të rrezikut bazohet kryesisht në

të dhënat empirike të nxjerra nga analiza e tipologjive të rasteve që kanë ndodhur në banka. Por, duhet marrë parasysh faktorët e rrezikut të identifikuar në raportet e tipologjive nga burimet relevante të jashtme (organet qeveritare, organizatat ndërkombëtare, dokumentet kërkimore, raportet e medias etj.).

**3.1 VLERËSIMI I RREZIKUT TË KLIENTIT**

Vlerësimi i rreziqeve që lidhen me klientët e bankave bazohet në një numër të

tipeve të klientit, pronësisë, industrisë, veprimtarisë, profesionit dhe / ose biznesit, krahas faktorëve të tjerë, siç është gjatësia e marrëdhënies së klientit me bankën. Disa faktorë që mund të ndikojnë në vlerësimin e rrezikut të klientëve janë: vendi i banimit, vendi i aktivitetit, sektori i aktivitetit, prania e PEP, incidentet financiare, flukset ndërkuftare, produktet e ndjeshme të përdorimit, vendi i themelimit, ndjeshmëria e sektorit, data e krijimit (për personat juridikë). Modeli i vlerësimit të rrezikut të klientit zgjerohet me kritere të lidhura me klientin për të kuptuar aspektet specifike të rreziqeve, që mund të lidhen me klientët. Bazuar në këta faktorë secilit tip të klientit i është caktuar një pikë e rrezikut, në varësi të pritshmërisë së rrezikut të pastrimit të parave, që bart çdo lloj rreziku. Të dhënat mund të shfrytëzohen për të përcaktuar se çfarë përqindjeje e secilit tip të klientit klasifikohet sipas rezultatit të rrezikut, p.sh. rrezik i ulët kundrejt rrezikut të lartë, rreziku i mesëm kundrejt rrezikut të lartë, në mënyrë që të përcaktohet rreziku i përgjithshëm i klientit. Qasja e një banke për klasifikimin e rrezikut duhet të dokumentohet qartë dhe të përcaktohet në Politikat dhe Procedurat e brendshme të PPP.

### 3.2 VLERËSIMI I RREZIKUT TË PRODUKTEVE DHE SHËRBIMEVE

Vlerësimi i rreziqeve që lidhen me produktet e bankave bazohet në dëshmi empirike nga analiza e Raporteve të Aktivitetit të Dyshimtë (RAD), të paraqitura nga bankat brenda një periudhe kohore (p.sh. pesë vitet e fundit) dhe sipas metodologjisë së mëposhtme: llojet e transaksioneve dhe llojeve e produkteve të përfshira në të gjitha RAD për pesë vitet e fundit është matur kundrejt numrit të përgjithshëm të RAD gjatë kësaj periudhe. Për të vlerësuar normat që rezultojnë duhet të interpretohen si probabiliteti i ndodhjes së një lloji të caktuar në një RAD. Vlerat e mëposhtme të pragut mund të aplikohen:



< 4.99% =  
Rrezik i ulët



5 - 9.99% =  
Rrezik i mesëm



> 10% =  
Rrezik i lartë

Llojet e produkteve ose llojet e transaksioneve të pranishme në më shumë se për shembull 15% e të gjitha RAD konsiderohen të jenë me rrezik më të lartë. Dy shembuj: llogaritë rrjedhëse janë shërbimi bazë; prandaj ato janë të përfshirë në shumicën dërrmuese të të gjitha RAD-ve. Po ashtu, bankat që veprojnë në tregjet intensive me para të gatshme. Prandaj, cash-i është i përfshirë në shumicën e RAD. Rrjedhimisht, pagesat në para të gatshme klasifikohen me rrezik më të lartë në lidhje me rreziqet PP/FT.

### 3.3 VLERËSIMI I RREZIKUT TË VENDIT

Metodologjia e vlerësimit të vendit përkraan kërcënimin që bankat mund të keqpërdoren për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit nëpërmjet përfshirjes së disa vendeve. Treguesit Botëror të Qeverisjes (ang. WGI- Worldwide Governance Indicators) të Bankës Botërore dhe Indeksi i Fshehtësisë Financiare (ang. FSI - Financial Secrecy Index) i Rrjetit të Drejtësisë Tatimore (Tax Justice Network) do të merren parasysh për të vlerësuar ekspozimin e një vendi ndaj rreziqeve të pastrimit të parave dhe flukseve të tjera të paligjshme financiare, përveç informacionit më tradicional dhe burimet si Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit (ang. CPI - Corruption Perception Index) i Transparency International.

Përveç vlerësimit sasior, një analizë cilësore e mjedisit të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit përfshihet në profilin e rrezikut të bankave. Pjesa cilësore vlerëson kuadrin e përgjithshëm dhe situatën e përgjithshme për bankat në vendin e operimit dhe është mjaft përshkruar. Vlerësimi cilësor mund të përdoret nga burime të ndryshme, duke përfshirë:

- Informatat aktuale nga Task Forca për Veprime Financiare (ang. the Financial Action Task Force)
- Vlerësimi kombëtar i rrezikut të PPP për vendin
- Rishikimet e Komitetit të Ekspertëve të Këshillit të Evropës mbi Vlerësimin e Masave të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEVAL)
- Programi i Vlerësimit të Sektorit Financiar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)
- Raporti Ndërkombëtar i Strategjisë së Kontrollit të Narkotikëve (INCSR)

### 3.4 VLERËSIMI I RREZIKUT TË KANALEVE TË SHËRBIMEVE

Arsyetimi prapa vlerësimit të rrezikut të kanaleve të shërbimit është paksa i ndryshëm nga produktet e tjera. Këtu, klasifikimi bazohet në nivelin e anonimitetit që këto kanale ofrojnë kur shërbehet klienti. Niveli i anonimitetit të kanaleve të shërbimit i referohet vetëm shërbimit të klientit pas identifikimit fillestar. Këtu, për shembull, rreziku i mashtrimit konsiderohet më i lartë kur shërbimi i një klienti bëhet përmes e-banking se sa shërbimi i një klienti ballë për ballë. Në bazë të Wolfsberg Group's FAQ mbi vlerësimin të rrezikut për kanalet e shërbimit duhet të vlerësohet nëse dhe deri në ç'masë mënyra e hapjes së llogarisë ose shërbimi i llogarisë, si hapja e llogarisë jo-ballë për ballë me klientin ose përfshirja e palëve të treta, duke përfshirë ndërmjetës, mund të rrisë rrezikun e pastrimit të parave. Për këtë kategori rreziku, bankat duhet të

përcaktojnë/vlerësojnë përqindjen e llogarive, p.sh. rrezik i ulët kundrejt rrezikut të lartë, rrezik i mesëm kundrejt atij të lartë etj., me qëllim të përcaktimit të rrezikut të qenësishëm të kanaleve të shërbimit.

### 3.5 EFEKTIVITETI I KONTROLLËS

Pas hapit të parë të vlerësimit, përcaktimi i rreziqeve të qenësishme, mekanizmi i kontrollit të brendshëm duhet të vlerësohet për të përcaktuar sa efektivisht mënjanojnë rreziqet e përgjithshme. Kontrollat janë mekanizëm thelbësor për të zvogëluar rreziqet e identifikuar. Kontrollat e ndryshme zbatohen për aktivitete të ndryshme të kryera brenda bankave dhe kryhen nga organe të ndryshme (p.sh. Zyra për shërbim të klientëve - Linja 1, Pajtueshmëria – Linja 2 dhe Auditimi - Linja e 3-të). Sipas Wolfsberg Group's FAQ mbi Vlerësimin e Rrezikut, kontrollat e PPP janë si më poshtë: Qeverisja Korporative për PPP; Mbikëqyrja e Menaxhmentit dhe Përgjegjësitë, Politikat dhe Procedurat, Principi Njih Klientin Tuaj (ang. KYC - Know Your Customer); Kujdesi i Duhur ndaj Klientit (ang. CDD - Customer Due Diligence); Kujdesi i Duhur i Shtuar ndaj Klientit (ang. ECDD - Enhanced Customer Due Diligence), Vlerësimet tjera paraprake të rrezikut (lokale dhe më gjerë), Menaxhimi i informatës/raportimi, Ruajtja dhe arkivimi, emërimi i Zyrtarit të pajtueshmërisë/Njësia për Pajtueshmërinë me PPP, Zbulimin dhe paraqitjen Rasteve të Aktiviteteve të Dyshimta (RAD), Monitorimi dhe Kontrollat, Trajnimet, Testimin e Pavarur dhe Mbikëqyrjen.

### 3.6 VLERËSIMI I RREZIKUT REZIDUAL

Për të përcaktuar rrezikun rezidual (të mbetur) në bazë të faktorëve të përcaktuar më sipër, është e nevojshme të shqyrtohen rreziqet përkatëse kundër të gjitha masave lehtësuese në dispozicion. Megjithatë, disa prej masave lehtësuese të aplikuar kanë një potencial më të madh për zvogëlim të rrezikut se sa masat e tjera të zbatua-



ra. Bankat konsiderojnë se masat për të zvogëluar rrezikun duhet të jenë qenësore për menaxhimin e rreziqeve, që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe aktet e tjera të dënueshme me ligj. Kjo përfshin praninë e Zyrtarit të Përpunueshmërisë, i cili shërben si pronar i Politikës NjKT dhe koordinator i të gjitha aktiviteteve të PPP dhe LFT, një parim për zbatim të NjKT dhe procedura/politika të përcaktuara mirë për Kujdesin e Duhur ndaj Klientit, që rregullojnë informacionin e klientit dhe kategorizimin e rrezikut si dhe ngritjen e rregullt të ndërgjegjësimit dhe trajnimit për PPP.

Gjatë vlerësimit të rrezikut të mbetur (rezidual) nga probabiliteti i shfaqjes dhe efikasiteti i masave, mund të përdoret metodologjia/matrica në vijim (tabela 1):



### 4 DERIVIMI I EVIDENCËS NGA VLERËSIMI I RREZIKUT TË PPP

Me qëllim të nxjerrjes së provave nga Vlerësimi i Rrezikut të PPP, i cili mund të zbatohet nga një sistem i monitorimit të bazuar në teknologji informative, duhet të merren në konsideratë të gjitha rezultatet e modelit të matjes së rrezikut të përshkruar më sipër. Bazuar në profilin e rrezikut të bankave, indikatorë të caktuar aplikohen për të monitoruar transaksionet, që adresojnë rreziqet

specifike në banka. Ato reflektohen në profilet e rrezikut të PPP për bankat dhe rezultatet e tyre analizohen për të përcaktuar efektivitetin e tyre. Më tej, të gjitha të dhënat e RAD-it vlerësohen për të përcaktuar profilin e rrezikut të bankave. Kjo u ofron bankave të dhëna për përshtatjet e nevojshme të skenarëve individual të monitorimit.



### 5 ZHVILLIMI I MËTUTJESHËM I MASAVE PËR ZVOGËLIM TË RREZIKUT

Duke marrë parasysh të gjitha rezultatet e Vlerësimit të Rrezikut të PPP, masat e zbatuara tashmë për parandalimin e pastrimit të parave mund të vlerësohen dhe zhvillohen më tej, nëse është e nevojshme. Vlerësimi i Rrezikut të PPP do të përcaktoj masat e nevojshme për të rritur masat për ekspozimin ndaj rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Institucionet Financiare dhe të përshkruajë zbatimin e masave të nevojshme për të parandaluar më tej këtë rrezik. Vlerësimi i rrezikut për PPP të Institucioneve Financiare duhet të shpalosen tek Menaxhmenti i Lartë i Institucioneve Financiare si dhe me Komitetin e Auditimit në mënyrë që të mundësohet adresimi i të gjitha rreziqeve të identifikuar gjatë analizës.

Tabela 1 – Matrica e metodologjisë së vlerësimit të rrezikut

Probabiliteti i ndodhjes	Efektiviteti i masave	Rreziku rezidual
! I ULËT	! I ULËT	! I ULËT
! I ULËT	! I MESËM	! I ULËT
! I ULËT	! I LARTË	! I ULËT
! I MESËM	! I ULËT	! I MESËM
! I MESËM	! I MESËM	! I MESËM
! I MESËM	! I LARTË	! I ULËT
! I LARTË	! I ULËT	! I LARTË
! I LARTË	! I MESËM	! I MESËM
! I LARTË	! I LARTË	! I MESËM

Një shembull se si banka i qaset peshimit të rreziqeve është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 2 – Vlerat e rrezikut të qenësishëm

Rreziku i qenësishëm		
6	5	4
! I LARTË	! I MESËM	! I ULËT

Tabela 3 - Efektiviteti i masave

Efektiviteti i masave		
3	2	1
● I FORTË	○ ADEKUATE	○ I DOBËT

Tabela 4 – Nivelet e “scoring-ut”

Niveli i “scoring-ut”			
Vlerësimi i rrezikut të qenësishëm		Vlerësimi i rrezikut rezidual	
Mesatarja	Niveli i rrezikut	Mesatarja	Niveli i rrezikut
0 – 4	! I ULËT	0 – 2.0	! I ULËT
4.1 – 5.4	! I MESËM	2.1 – 3.4	! I MESËM
5.5 -	! I LARTË	3.5 -	! I LARTË

Matrica e cila përdoret për të llogaritur rrezikun është si më poshtë:

Tabela 5 – Matrica për rrezikun rezidual

MATRICA	Niveli i “scoring-ut”			
	Vlerësimi i rrezikut rezidual	Vlerësimi i rrezikut rezidual	Vlerësimi i rrezikut rezidual	
Rreziku i qenësishëm	I Lartë (6)	3 - ! I MESËM	4 - ! I LARTË	5 - ! I LARTË
	I Mesëm (5)	2 - ! I ULËT	3 - ! I MESËM	4 - ! I LARTË
	I Ulët (4)	1 - ! I ULËT	2 - ! I ULËT	3 - ! I MESËM
Rreziku rezidual				

#### Shpjegim rreth matricës:

- Nëse rreziku i qenësishëm është i **Lartë (6)** dhe efektiviteti i masave është i **Fortë (3)** rreziku rezidual (i mbetur) është i **Mesëm (3)**, bazuar në nivelet e vlerësimit (ju lutemi referojuni tabelës së mësipërme për nivelet e “scoringut”);
- Nëse rreziku i qenësishëm është i **lartë (6)** dhe efektiviteti i masave është **Adekuat (2)** rreziku rezidual është i **Lartë (4)**.



**DAFINA DOBROSHI-KABASHI**  
Udhëheqëse e Riskut Operacional  
ProCredit Bank Kosova

# Sigurimi i riskut dhe pajtueshmërisë në nën kontraktimin (outsourcing) e aktiviteteve nga rregullatori gjerman dhe perspektiva e praktikave më të mira

**N**ë mjediset e sotme dinamike, institucionet financiare në vazhdimësi rrisin kompleksitetin duke lëvizur në drejtim të nën kontraktimit / zgjidhjeve të palëve të treta me ofruesit vendas dhe të huaj të shërbimeve. Marrëveshjet e zakonshme për nën kontraktim që ngërthejnë në vete risk, përfshijnë sa vijon, dhe jo vetëm:

- Nën kontraktimi i funksioneve të plota bankare tek ofruesit e shërbimeve që janë palë të treta
- nën kontraktimi i linjave apo produkteve afariste
- Përqendrimi i nën kontraktimit të aktiviteteve te një ofruesi i vetëm palë e tretë (në treg) për të kryer aktivitete të shumfishta ose kritike
- Lejimi i ofruesve të shërbimeve që të ndërveprojnë drejtpërdrejt me klientët (kryesorë) të institucionit
- Dhënia e të drejtës palëve të treta për të nënkontraktuar aktivitetet të institucionit me ofruesit e tjerë (vendas ose të huaj).



Bazuar në përkufizimet e praktikave më të mira, një aktivitet klasifikohet si nën kontraktim kur institucioni mandaton një ofrues tjetër të palës së tretë për të kryer aktivitetet/shërbimet e tij thelbësore që përndryshe ai do t'i kryente vetë. Në parim, të gjitha aktivitetet mund të nënkontraktohen përderisa nën kontraktimi nuk çon në një kompani guaskë dhe për sa kohë që institucioni mund të sigurojë monitorim të duhur dhe vazhdimësi të biznesit për aktivitetet e nën kontraktuara gjatë gjithë kohës.

Kornizat e veçanta rregullatorë të BE-së, siç është ligji gjerman<sup>1</sup> gjegjësisht dispozita § 25b e Aktit Bankar Gjerman [Kreditwesengesetz -KWG] në lidhje me AT 9 të Kërkesave Minimale për Menaxhimin e Riskut [Mindestanforderungen an das Risikomanagement - MaRisk] specifikojnë se funksionet kryesore të menaxhimit, të tilla si organet vendimmarrëse si Bordi Menaxhues, strategjia e biznesit dhe përkufizimi dhe planifikimi i biznesit nuk mund të nënkontraktohen. Në përgjithësi, aktivitetet dhe proceset mund të nënkontraktohen për aq sa organizimi i duhur dhe vazhdimësia e biznesit nuk dëmtohen, në pajtim me nenin 25a (1) të Aktit Bankar.

Përveç kësaj, duhet të zbatohen kritere të veçanta në lidhje me nën kontraktimin e plotë ose të pjesshëm të funksioneve specifike, siç janë kontrolli i riskut, pajtueshmëria dhe auditimi i brendshëm. Bazuar në versionin e fundit të ndryshuar të MaRisk nga BaFin, ndryshimet kryesore të kërkesave të reja kryesisht lidhen me fusha të tilla si nën kontraktimi, raportimi i riskut, agregimi i të dhënave dhe kultura e riskut.

Në fushën e nënkontraktimit, BaFin vë theks të veçantë në dobësitë e identifikuar, dhe përmes versionit të ndryshuar të rregullores përcakton risqet e veçanta që lidhen me humbjen e kontrollit dhe humbjen e ekspertizës së aktivitetit të nën kontraktuar nga ana e institucioneve. Si kërkesë minimale, rregullorja kërkon që institucionet bankare të mbajnë ekspertizën e tyre për të siguruar monitorimin e duhur të aktiviteve të nën kontraktuara. Bazuar në këto kërkesa, institucionet financiare duhet të kenë mekanizma të duhur për të siguruar vazhdimësinë e biznesit në rast se aranzhimet e nën kontraktuara pushojnë për çfarëdo arsye, si dhe për të ruajtur ekspertizën e tyre të brendshme minimale për monitorimin e duhur të aktivitetit të nën kontraktuara.

<sup>1</sup> BaFin - Autoriteti Federal Gjerman i Mbikëqyrjes Financiare



**Bazuar në versionin e fundit të ndryshuar të MaRisk nga BaFin, ndryshimet kryesore të kërkesave të reja kryesisht lidhen me fusha të tilla si nën kontraktimi, raportimi i riskut, agregimi i të dhënave dhe kultura e riskut.**

Në versionin e ndryshuar të MaRisk janë specifikuar shpjegime plotësuese si dhe kërkesa të reja në fushën e prokurimit të jashtëm të mallrave dhe shërbimeve veçanërisht lidhur me blerjen e softuerit (TI). Si rregull e përgjithshme, MaRisk shpjegon se prokurimi i izoluar i softuerit që përdoret, siç janë shërbimet mbështetëse, në përgjithësi nuk duhet të klasifikohet si nën kontraktim. Megjithatë, rregullorja bën dallim te blerja e softuerit (TI) që përdoret nga institucionet për të identifikuar, vlerësuar, menaxhuar dhe monitoruar ose raportuar risqet me rëndësi materiale për aktivitetet bankare. Në përputhje me rregulloren, operimi i softuerit nga pala e tretë e jashtme duhet të klasifikohet si nën kontraktim dhe se duhet të zbatohen dispozitat standarde të kërkesave lidhur me nën kontraktimin.

Kërkesat e mëtutjeshme nga perspektiva e rregullimit me MaRisk specifikojnë se nuk lejohet nënkontraktimi i plotë i funksioneve të tilla si kontrolli i riskut, pajtueshmëria dhe auditimi i brendshëm. Të paktën, institucionet duhet të vlerësojnë dhe të përcaktojnë si dhe nëse mund të sigurojnë që aktivitetet e nën kontraktuara lidhur me këto funksione dhe procese mund të integrohen në menaxhimin e përditshëm të riskut.

MaRisk kërkon që institucionet bankare të krijojnë një njësi të centralizuar për nënkontraktuar, përgjegjësia kryesore e së cilës do të ishte të mbikëqyrë rregullisht aktivitetet e nën kontraktuara për të parë nëse aktivitetet e nën kontraktuara përkojnë me



Kërkesat e mëtutjeshme nga perspektiva e rregullimit me MaRisk specifikojnë se nuk lejohet nënkontraktimi i plotë i funksioneve të tilla si kontrolli i riskut, pajtueshmëria dhe auditimi i brendshëm.

marrëveshjet kontraktuese dhe të nivelit të shërbimeve. Njësia e centralizuar gjithashtu do të ofrojë udhëzime për mbështetjen e njësive organizative në vlerësimin e riskut dhe shqyrtimin e marrëveshjes së nënkontraktuar për të parë nëse janë adresuar kërkesat minimale të nën kontraktimit. Në këtë mënyrë, monitorimi efektiv i aktivitetit të nën kontraktimit sigurohet rregullisht duke ndarë rezultatet e vlerësimit të performancës me bordin menaxhues, qoftë drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet komiteteve të veçanta të riskut brenda institucioneve.

Nga perspektiva e menaxhimit të riskut, është e rëndësishme të mbahet një proces i menaxhimit të riskut ndaj marrëdhënieve me palë të treta (nën kontraktuar) duke filluar nga fazat fillestare dhe gjatë gjithë ciklit të nën kontraktimit. Kjo fillon nga fazat e tilla si identifikimi i ofruesve të mundshëm të shërbimit, kujdesi i duhur në raport me ofruesit e mundshëm të shërbimeve, deri te monitorimi i vazhdueshëm i performancës dhe madje edhe vlerësimet e riskut lidhur me pushimin e nën kontraktimit.

Pavarësisht nëse institucionet përcaktohen për nën kontraktim të plotë ose të pjesshëm të produkteve ose linjave të tyre të biznesit apo nëse aktivitetet e nën kontraktuar janë klasifikuar si materiale apo jo materiale, nga çdo aktivitet i nënkontraktuar do të lindin risqe. Rekomandohet që të merret parasysh një numër minimal i elementeve në mënyrë që aktiviteti i nënkontraktuar të menaxhohet në mënyrë të duhur dhe të sigurohet

menaxhimi efektiv i riskut. Përveç metodologjive efektive të administrimit të riskut, varësisht nga vendi i operimit dhe juridiksioni në të cilin operojnë, bankave u kërkohet të sigurojnë pajtueshmëri të plotë me kërkesat rregullatorë në çdo kohë.

Nga perspektiva e menaxhimit efektiv të riskut, elementet e mëposhtme shërbejnë si udhëzues për të siguruar që risqet e nën kontraktimit me ofruesit e shërbimeve janë vlerësuar dhe monitoruar në mënyrë të duhur:

1

### Kujdesi i duhur ndaj ofruesve të mundshëm të shërbimeve

- Stabiliteti financiar (pasqyrat financiare të audituara)
- Kontrollat lidhur me pastrimin e parasë (AML)
- Zgjidhjet rezervë / rrethanat e paparashikueshme
- Zotësia për t'iu përgjigjur çrregullimeve
- Vlerësimi i strukturës organizative të ofruesit të shërbimeve

2

### Vlerësimi i riskut të nën kontraktimit

Institucionet duhet të kryejnë vlerësimin e brendshëm të riskut bazuar në një sërë kriteresh që do t'u mundësojnë atyre të vlerësojnë rëndësinë dhe risqet me të cilat ballafaqohen në përpjesëtim me aktivitetet e nën kontraktimit. Disa nga kriteret që duhet të merren parasysh përfshijnë sa vijon, dhe jo vetëm: përqendrimet potenciale të riskut, risqet e varësisë nga ofruesit e shërbimeve, strategjitë dalëse dhe kostot, risku nga nën kontraktimi, risqet lidhur me mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë e informacionit, etj. Bordi Menaxhues duhet të jetë i vetëdijshëm për risqet e vetvetishme dhe të mbeturta dhe duhet të propozohet zbutja e riskut dhe të ndërmerren veprime pasuese. Kompleksiteti dhe fushëveprimi i vlerësimit varet nga rrezikshmëria e aktiviteteve dhe proceseve të nënkontraktuar. Për shembull, për eksternalizim të funksioneve materiale apo specifike, siç është kontrolli i riskut, pajtueshmëria ose auditimi i brendshëm, institucioni duhet të marrë parasysh sesi do t'i integrojë aktivitetet e nënkontraktuar në kornizën dhe metodologjitë e menaxhimit efektiv të riskut.

3

### Duhet të specifikohen elementet minimale të marrëveshjes së nënkontraktimit (niveli i shërbimeve) si vijon:<sup>2</sup>

- Përshkrimi i hollësishëm i shërbimeve që duhet të ofrohen nga ofruesi i shërbimit
- Të drejtat e nën kontraktimit të ofruesit të shërbimeve dhe nëse institucioni ndalon nën kontraktimin e nënkontraktuesve apo vendndodhjeve të caktuara
- Të drejtat e pushimit të nën kontraktimit dhe periudhat e njoftimit
- Auditorët e brendshëm, auditorët e jashtëm dhe autoritetet mbikëqyrëse kanë të drejta të pakufizuara për të ekzaminuar aktivitetet e nënkontraktuar
- Detyrimi i ofruesit të shërbimeve për të informuar institucionin për çdo zhvillim që mund të dëmtojë kryerjen e duhur të aktiviteteve dhe proceseve të nënkontraktuar.

### Klauzolat e tjera të rekomanduara nga perspektiva e praktikave të menaxhimit të riskut përfshijnë sa vijon, dhe jo vetëm:

- Përkufizimi i treguesve kryesorë të performancës
- Brenda institucionit duhet të vendoset për shkallën e performancës së dobët që ai është i gatshëm ta pranojë. Kjo mund të përkufizohet nëpërmjet një sërë treguesish kryesorë të performancës si njësi matëse minimale dhe përcaktimit të masave që duhet të ndërmerren në rast të mos përmbushjes së synimeve tilla të matshme.
- Klauzolat e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave
- Planet për vazhdimësi të biznesit (rrethanat e paparashikueshme) nga perspektiva e ofruesit të shërbimit në përputhje me planet e bankës për situatat e paparashikueshme



4

### Strategjitë dalëse

Institucionet financiare në çdo kohë duhet të kenë plane për situatat e paparashikueshme, qoftë për t'i kaluar aktivitetet te një ofrues tjetër i shërbimeve në treg ose për t'i rikthyer aktivitetet brenda institucionit. Është thelbësore që institucioni gjatë fazës së vlerësimit të riskut të nënkontraktimit të vlerësojë një periudhë të përfaqësues kohore që pret se do t'i duhet për zbatimin e strategjisë dalëse në përputhje me kompleksitetin e aktivitetit të nënkontraktimit pa dëmtuar operacionet e veta.

5

### Monitorimi dhe mbikëqyrja e vazhdueshme e aktiviteteve të nënkontraktuar

Institucionet financiare duhet të mbikëqyrin aktivitetet e tyre të nën

kontraktuar gjatë gjithë kohës. Për ta zbatuar këtë, në rastin e rregullatorit gjerman (BaFin MaRisk), aktivitetet e nënkontraktuar duhet të monitorohen siç duhet në bazë të kriterëve të paracaktuar ndërmjet ofruesve të shërbimeve dhe bankës. Në rast të dëmtimit të treguesve të performancës duhet të merren menjëherë masat adekuate.

6

### Sigurimi ndaj palës së tretë

Nga perspektiva e praktikave më të mira, rekomandohet në mënyrë të theksuar që përveç marrëveshjeve kontraktuese, këto institucione të kërkojnë mbulim me sigurime për aktivitetet e nënkontraktuar, veçanërisht në rast të aktiviteteve materiale kritike. Llojet e mbulimit me sigurime mund të përfshijnë: sigurimin e mashtrimit, sigurimin e përgjegjësisë, sigurimin e rrezikshmërisë dhe sigurimin e pronësisë intelektuale.

<sup>2</sup> BaFin MaRisk



**BORYANA IVANOVA MUSTAFA**Udhëheqëse e Divizionit të Pagesave dhe Thesarit  
NLB Banka

# €STR – Algjebra e porsalindur e bankave (The NEWBORN)

**N**ormat referente të interesit përdoren kryesisht si referencë në kontratat që indeksohen me norma interesi të ndryshueshme nga një shumëllojshmëri institucionesh financiare, duke filluar nga bankat që ofrojnë kredi për bizneset dhe qytetarët deri tek formuesit e tregut të derivativëve. Përdorimi i normave referente për çmim vënie të kontratave financiare lehtëson standardizimin dhe mundëson funksionimin më të lehtë të tregjeve financiare. Normat referente janë gjithashtu të rëndësishme për bankat qendrore. Politika monetare transmetohet nëpërmjet tregjeve financiare dhe normat referente luajnë një rol kyç në zbatimin dhe monitorimin e transmetimit të politikës monetare të Bankës Qendrore.

Norma të tilla referente përdoren gjerësisht për vlerësimin e zërave të bilancit, kryesisht si norma skontimi për disa instrumente financiare ose në vlerësime për qëllime kontabiliteti. Ato përdoren gjerësisht si një indeks për kontratat e kredive për klientët individual, si dhe nga tregjet e derivativëve në produkte siç janë këmbimet e interesit, opsione dhe kontrata me datë valutës në të ardhmen (forward contracts).

Normat referente më të përdorura për normat e interesit për kontratat në valutën Euro janë EONIA (Norma e ofruar mesatare ndër bankare Euro gjatë natës)

PARA KRIZËS, VËLLIMI  
VJETOR MESATAR EONIA-S  
KA VARIUAR PREJ

**32**  
MILIARDË EURO  
NË VIT

DERI MË

**48**  
MILIARDË EURO  
NË VIT


dhe EURIBOR (Norma e ofruar ndër bankare euro), e administruar nga Instituti Evropian i Tregjeve të Parave (EMMI). Të dy Indekset EURIBOR dhe EONIA janë të bazuara në huamarrjen aktuale dhe huadhënien në tregun e parasë ndër bankar të pasiguar.

Komisioni Evropian ka vlerësuar se kontratat që indeksohen me normën EURIBOR kapin vlerën prej rreth EUR 180 trilionë. Shumica e këtyre kontratave janë këmbime të normave të interesit, në të cilat shkëmbehet një normë interesi fikse për një normë variabile. Por kontratat e tilla gjithashtu përfshijnë kredi me segmentin e klientëve individual ose obligacione me norma të ndryshueshme.

EURIBOR është një normë referente që jep një tregues të normës mesatare në të cilën bankat japin hua të pasigurta në tregun ndër bankar të euros për një periudhë të caktuar. Norma përcaktohet çdo ditë nga EMMI në bazë të kuotimeve të një paneli prej 20 bankave nga BE që kontribuojnë në baza vullnetare. Publikohet çdo ditë në orën 11:00 të mëngjesit.

EONIA është një normë referente e bazuar në transaksione reale. Ajo llogaritet si një mesatare e ponderuar e të gjitha transaksioneve ndër bankare të huave të pasiguruara brenda bankës së panelit prej 28 bankave dhe publikuar

Vëllimet e EONIA janë ulur më tej, në një mesatare vjetore prej 7 miliardë eurosh në 2017. Më 31 tetor 2018, EONIA u botua në bazë të një aktiviteti prej 488 milionë eurosh



Përqendrimi i vëllimit EONIA: midis viteve 1999 dhe 2009, rreth 51% e vëllimit të përgjithshëm të përditshëm EONIA u raportuan nga 5 bankat më aktive në panelin Eonia. Në vitin 2019, rreth 81% të vëllimit u raportuan nga pesë bankat e para. Në vitin 2017, ky përqendrim tregojë në 88%.

të njëjtën ditë deri në orën 19:00 CET. Banka Qendrore Evropiane vepron si agjent llogaritës për EONIA dhe përpilon kontributet ditore të bankave nga paneli EONIA dhe komunikon normën përfundimtare në EMMI.

Përdorimi i një norme ndër bankare, siç është EONIA, pasqyron faktin se tregu ndër bankar në të kaluarën është perceptuar si treg i besueshëm për formimin e një treguesit aq të dobishëm.

Mirëpo, ambienti aktual i politikës monetare në vitet e fundit, së bashku me masat tjera makroekonomike, normat e ulta të interesit dhe provizionet e larta për menaxhimin e mjeteve likuide, nuk inkurajojnë më huazimin afatshkurtër mes bankave. Bankat nuk mbështeten


më në financimin ndër bankar aq sa përdorin dhe burime të tjera financimi përtej tregut ndër bankar ose tregut të pasiguar që mund të merret parasysht në llogaritjen e një Indeksi.

Prandaj, gjatë disa viteve të fundit, besimi në ato indekse është zbehur për shkak të vëllimeve shumë të ulëta për të qenë realiste dhe për të pasqyruar çmimin e vërtetë të tregut. Të dy standardet aktualisht mbështeten në kontributet vullnetare të dy paneleve të bankave, numri i të cilave ka rënë ndjeshëm në vitet e fundit.


Për të luftuar këtë dobësi, EONIA dhe EURIBOR aktualisht janë duke kaluar nëpër reforma të thella nën udhëheqjen e EMMI. Këto reforma synojnë të bëjnë të

dy standardet në pajtim me Rregulloren e re të Benchmarkeve të BE (BMR), që ka hyrë në fuqi në janar 2018. Pas një periudhe tranzicioni, kërkesat e BMR-së do të bëhen plotësisht të detyrueshme deri në janar 2020. BMR imponon - Certifikimi tekniko-legal, që është subjekt të standardeve të reja për saktësi dhe transparencë për të ruajtur stabilitetin e paneleve EURIBOR dhe EONIA.

Duke pasur parasysht rëndësinë sistematike të normave referente dhe ndikimin masiv në Eurosistemin, Këshilli Drejtues i BQE-së ka marr vendimin për të zhvilluar një normë të re të qëndrueshme euro afatshkurtër, e quajtur €STR (ESTER).



Burim: Konsultimi i tretë publik nga grupi punues në norma pa rrezik mbi EONIA drejt €STR – Plani aksional ligjor



Më 31 tetor 2018, EONIA u botua në bazë të një qarkullimit vjetor të vetëm 488 milionë euro. Mangësitë e tjera të EONIA-së kanë qenë koncentrimi i vëllimit të treguesit EONIA: midis viteve 1999 dhe 2009, rreth 51% e vëllimit të përditshëm EONIA u raportuan nga 5 bankat më aktive në panelin EONIA.

### Zbarkimi i EONIA-së në €STR

Para krizës, vëllimi vjetor mesatar të EONIA-së ka variuar prej 32 miliardë euro deri më 48 miliardë në vit. Megjithatë, në vitet e fundit për shkak të mungesës së stimulujve për bankat që të angazhohen në kreditimin ndër bankar, vëllimet e EONIA kanë rënë ndjeshëm, në një mesatare vjetore prej 7 miliardë eurosh në vitin 2017. Më 31 tetor 2018, EONIA u botua në bazë të një qarkullimit vjetor të vetëm 488 milionë euro. Mangësitë e tjera të EONIA-së kanë qenë koncentrimi i vëllimit të treguesit EONIA: midis viteve 1999 dhe 2009, rreth 51% e vëllimit të përditshëm EONIA u raportuan nga 5 bankat më aktive në panelin EONIA. Në 2017, 88% e vëllimit

u raportua nga vetëm top pesë bankat më të mëdha

Për shkak të transaksioneve të ulëta të ndërlidhura dhe koncentrimin i lartë të panelit, EONIA nuk do të përmbushë kriteret e Rregullores BMR. Tregu duhet të lëvizë nga një normë referente jo e qëndrueshme në një normë referente e qëndrueshme deri në përfundimin e periudhës tranzitore për implementimin e BMR-së.

E porsalindura €STR, e nisur në orbitën financiare në vitin 2017, ishte rekomanduar si një normë referente alternative e qëndrueshme pa rrezik. Grupi i punës për normën pa rrezik (RFR) ka rekomanduar që Instituti Evropian i Tregut të Parasë (EMMI) të modifikojë

metodologjinë aktuale EONIA për t'u bërë €STR plus një margjinë nga data e parë e publikimit të €STR, më 2 tetor 2019, deri në fund të vitit 2021, për t'u dhënë pjesëmarrësve të tregut kohë të mjaftueshme për të kaluar në €STR.

BQE do të fillojë të publikojë €STR deri në tetor 2019. Norma do të jetë në dispozicion në orën 09:00 në çdo ditë pune në TARGET2, bazuar në transaksionet aktuale individuale nga dita e mëparshme. Ajo do të publikohet në faqen e internetit të BQE-së.

Pas 2 tetorit 2019, në rast se që është operacionalisht e mundur, pjesëmarrësit e tregut duhet të konsiderojnë të mos hyjnë në kontrata të reja që kanë të bëjnë me EONIA, në veçanti kontratat e

<b>Emri</b>	<b>EONIA</b>	<b>€STR</b>
	EUR	EUR
<b>Ngjajshmëri</b>	Gjatë natës (O/N)	Gjatë natës (O/N)
	Pasiguruar	Pasiguruar
	Bazuar në tranzakcione	Bazuar në tranzakcione
<b>Definicion</b>	EUR O/N transaksione ndër bankare të huadhënies së pasiguruar	EUR O/N transaksione të huamarrjes me shumicë të pasiguruar
<b>Baza e të dhënave</b>	Panel jo-stabil 28 banks (19 MMSR)	Panel stabil (varet nga të dhënat e mbikëqyrura) 52 banka MMSR (Raporti statistikor MMSR)
<b>Administrator</b>	EMMI	ECB (BQE)
<b>Baza e të dhënave</b>	Paneli i ngushtë	Paneli i gjerë
<b>Metodologji</b>	Pa limit	Prej EUR 1 million me përshtatje 25%
<b>Rregullorja BMR</b>	Në kundërshtim	Në harmoni
<b>Publikim</b>	Publikohet gjatë ditës (prej 2 Tetorit 2019 në ditën e ardhshme të punës në orën 11:00)	Publikohet të nesërmen Në orën 9:00 a.m (prej 2 Tetorit 2019)
<b>Vlera e përcaktuar</b>	Përafërsisht - 0.36%	Përafërsisht - 0.44%
<b>Të dhënat historike</b>	Nga 01/99	Nga 06/16

Burimi: WG EuroRFR-Subgroup#4 dhe prezantimi nga Bayern Bank

## Transition: When Will It Happen?



reja që maturojnë pas datës 31 dhjetor 2021 ose duhet të konsiderojnë përfshirjen e klauzoleve rezervë në lidhje me normën e rekomanduar alternative për EONIA.

Norma e re referente afatshkurtër (€STR) do të bazohet në të dhënat që janë veç të disponueshme në Eurosistemin dhe do të merr parasysh jo vetëm transaksionet ndër bankare, por edhe transaksionet me kompani tjera, siç janë fondet e tregut të parasë, kompanitë e sigurimit dhe kompanitë tjera financiare.

Kalkulimi do të bazohet plotësisht në huamarrjet individuale aktuale në valutën EUR, që raportohen nga bankat në bazë të Rregullores së EU-së MMSR Nr. 1333/2017.

Zbarkimi nga EONIA në €STR është një detyrë e madhe komplekse për të gjithë institucionet financiare dhe duhet të realizohet sa më butë në mënyrë që të mbrojtë integritetin e tregut dhe është

të jetë e drejtë për të gjitha përdoruesit e normave referente.

EURIBOR është normë referente që deri në vitin 2018 është kuotuar për 8 maturitete (një dhe dy javë, si dhe një, dy, tre, gjashtë, nëntë dhe dymbëdhjetë muaj). Maturitetet me përdorim më të ultë siç janë dy javore, dy mujore dhe nëntë mujore janë ndërprerë së publikuari më datën 3 Dhjetor 2018.

Komisioni Evropian kategorizoi EURIBOR-in si normë referente kritike, duke marr parasysh rëndësinë e saj sistematike për stabilitetin financiar dhe fakti që përdoret si një normë referente për një shumëllojshmëri të gjerë të produkteve dhe kontratave financiare, siç janë kreditë Retail dhe kreditë biznesi, letrat me vlerë të borxhit, produktet e derivateve si dhe depozitat.

Gjatë disa viteve të fundit EMMI ka zhvilluar një plan për të reformuar gradualisht normën EURIBOR në mënyrë

që të bazohet në transaksione në vend të kuotimeve. Reforma e EMMI-t në lidhje me EURIBOR-in është bërë e nevojshme edhe shkaku i Rregullores BMR së BE-së dhe udhëzimet ndërkombëtare që kërkojnë standardet të bazohen në një metodologji të fuqishme duke përdorur transaksionet e tregut kur të jetë e mundur për të plotësuar realitetin ekonomik të tregut që mbulon EURIBOR, të cilat kushte nuk ka gjasa të plotësohen nga kuotimet aktuale- bazuar në metodologjinë e tanishme të përdorur nga EMMI.

Prandaj, EMMI ka vendosur të eksplorojë mundësinë e një modeli hibrid ku metodologjia mbështetet në transaksione që janë të disponueshme dhe mbështetet në burime të tjera të lidhura me çmimet e tregut kur është e nevojshme. Një grup punues task force u krijua për të mbledhur opinionet e pjesëmarrësve të tregut dhe për të përpiluar udhëzime mbi metodologjinë e re. Gjatë vitit



2019, Autoriteti Belgjik për Shërbimet Financiare dhe Tregjet (FSMA), si autoritet përgjegjës për mbikëqyrjen e EURIBOR-it, është duke e vlerësuar nëse metodologjia e re është në përputhje me Rregulloren BMR. Sidoqoftë, përdoruesit e EURIBOR-it do të duhet të fusin klauzola rezervë për të përmirësuar qëndrueshmërinë e kontratave të tyre, siç kërkohet nga Rregullorja BMR.

Metodologjia e re hibride të EURIBOR-it parashikohet si një metodologji e fuqishme mjaft evolutive në krahasim me metodologjinë aktuale e bazuar në kuotimet dhe që do të jetë në përputhje me kërkesat e Rregullores BMR, por duhet të presë deri në vitin 2022.

Reforma e normave referente do të përfshijë të gjithë spektrin e institucioneve financiare dhe në fund të konsumatorët. Aspektet që lidhen me pajtueshmërinë dhe kontratat, si dhe me infrastrukturën teknike, janë më të ndryshme ndaj ndryshimit të normave. Bankat duhet të përballen me çështjet

komplekse të adaptimit të modeleve të vlerësimit në standardin e ri.

Sa i përket ndikimit në tregun e Kosovës, megjithëse vetëm një numër i kufizuar i bankave në tregun vendor ofrojnë produkte, kryesisht kredi, me norma të ndryshueshme ose norma të përziera (norma fikse + norma të ndryshueshme), angazhimi i bankave dhe të Bankës Qendrore kërkohet për tu siguruar që përshtatjet e nevojshme do të implementohen pa pasoja për bankat apo klientët e tyre.

Ende ka ende çështje të hapura dhe të panjohura të padefinuara, të cilat do të diskutohen më tej mbi konsultimet publike që inkurajojnë publikun të marrë pjesë gjatë vitit 2019. Megjithatë, sistemi financiar po përjeton një revolucion të normave të interesit, ku EMMI dhe BQE janë të angazhuar në një tranzicion delikatë mes normave të vjetra dhe të reja, subjekt të standardeve të reja të saktësisë dhe transparencës, një hap vendimtar përpara integritetit të tregjeve financiare të Eurosistemit.

#### Referencat:

[https://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/annex/ecb.sp190314\\_annex\\_recommendation.en.pdf](https://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/annex/ecb.sp190314_annex_recommendation.en.pdf)

<https://www.emmi-benchmarks.eu/euribor-eonia-org/eonia-consultations.html>

<https://www.emmi-benchmarks.eu/assets/files/D0062A-2019%20-%20EURIBOR%20Questions%20and%20Answers.pdf>

<https://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/other/ecb.sg3guidingprinciples201901.en.pdf>

[https://www.ecb.europa.eu/paym/initiatives/interest\\_rate\\_benchmarks/shared/pdf/ecb. ESTER\\_methodology\\_and\\_policies.en.pdf](https://www.ecb.europa.eu/paym/initiatives/interest_rate_benchmarks/shared/pdf/ecb. ESTER_methodology_and_policies.en.pdf)

WG EuroRFR-Subgroup#4 materials

<https://www.ecb.europa.eu/press/pr/date/2019/html/ecb.pr190531~a3788de8f8.en.html>

Other online sources and roundtables materials on euro risk-free rates benchmarks

**CHRISTOS ELEFTERIADIS**Këshilltar ekzekutiv për Evropë  
EZOPS

# Transformimi digjital në industrinë bankare

**S**hekuj me radhë, bankat kanë luajtur rolin e vajit në makineritë ekonomike të shoqërive. Tradicionalisht atyre u është dhënë shumë besim, gjë që natyrisht ka qenë e rëndësishme për ekzistencën e tyre. Kush do t'i sillte paratë e kursyera me shumë mund të dikush që nuk i besojnë? Një bankë zakonisht kishte mure të trasha dhe kasafortë të blinduar. Diçka që jepte përshtypjen e të qenit i pathyeshëm pavarësisht se çka do të ndodhte. Besimi i përgjithshëm ndaj bankave ka mbijetuar shtete, luftëra, depresione ekonomike dhe madje revolucione. Megjithatë, kriza financiare dhe një sërë skandalesh bankare kanë shkaktuar çarje të madhe në mur. Njerëzit e papërfshirë në punë të përditshme bankare nuk mund ta kuptonin se u deshën muaj të tërë që mijëra bankierë anembanë botës t'i binin në fije se cilat ishin pozicionet e tyre të hapura me Lehman Brothers pasi shpartallimit të tyre. Në epokën e kompjuterëve dhe të dhënave, kjo dukej se nuk ishte e mundur. Sidoqoftë, përfunduar me humbje të mëdha dhe banka që u mbyllën ose u shpëtuan nga shtetet, të cilët nga ana tjetër falimentuan dhe u desh të shpëtohen nga shtetet e tjera dhe institucionet mbikombëtare (FMN, BQE, MES). Komuniteti ndërkombëtar e kuptoi se duhej bërë diçka për të marrë



**Bankat më nuk janë vetëm! Pra, çka do të thotë kjo për bankat dhe çka mund të bëjnë bankat në mënyrë që të mbijetojnë në shekullin 21?**

kontroll më të mirë dhe transparencë të sektorit financiar dhe për të siguruar që një krizë e tillë nuk do të përsëritej. Si pasojë, bankave dhe firmave buy-side iu imponuan disa kërkesa dhe legjislacion i ri. Basel III, kërkesat e përditësuar të menaxhimit të riskut të likuiditetit (BCBS144) dhe kërkesat e reja për menaxhimin e riskut (BCBS239), MiFID I/II dhe EMIR janë vetëm disa nga bollëku i rregulloreve të reja të cilat duhet t'i respektojnë bankat. Shtu këtu dallimet specifike sipas vendit në interpretimin dhe rregulloret specifike të vendit, siç është Akti Dodd-Frank, dhe shpejt kuptohet se barra për bankat ka qenë e jashtëzakonshme në dekadën e

fundit. Përveç kësaj, ajo që kemi parë dekadën e fundit, dhe kjo paraqet ndryshim nga kohët e mëhershme, është përparimi me kërcime të teknologjisë, që i ka hapur udhë konkurrencës së pamëshirshme nga bizneset fillestare dhe kompanitë e mëdha të teknologjisë. Bankat më nuk janë vetëm! Pra, çka do të thotë kjo për bankat dhe çka mund të bëjnë bankat në mënyrë që të mbijetojnë në shekullin 21? Për t'iu përgjigjur kësaj, është me rëndësi që së pari të kuptojmë se cilat probleme i kanë bankat në përgjithësi.

Së pari, shumë banka janë mbështetur në procese dhe sisteme të vjetra, të cilat kanë rezultuar në jofleksibilitet dhe kosto të larta. Shumë procese ende përfshijnë shumë hapa manualë. Shkurtimi i kostove në masë të madhe u bë me anë të eksternalizimit të shërbimeve në vende ku krahu i punës është më pak i kushtueshëm, në vend të ballafaqimit me shkakun rrënjësor të problemeve.

Së dyti, në shumë raste cilësia e të dhënave është ende e dobët, duke çuar në ndërprerje dhe kosto të lartë të panevojshme për të hetuar dhe sanuar situatën. Përveç kësaj, cilësia e dobët e të dhënave gjithashtu ndikon në menaxhimin e likuiditetit të bankës, ku shumica e bankave nuk kanë të dhëna të sakta për pozicionet e disponueshme në kohë reale për qëllime të vendim-marrjes.

Së treti, kur njerëzit duhet të presin për procese të dengut, deri në ditën tjetër ose edhe më gjatë për të marrë të dhënat që i kërkojnë, për shembull pozicionet, vështirë se mund të thuhet që disponueshmëria është e mirë. Në kohën e lëvizjes brenda ditës, në kohë reale dhe të atypëratyshme të fondeve, bëhet e pamundur që të menaxhohet banka kur të dhënat nuk janë të disponueshme në kohë reale, pa përdorur tamponë të mëdhenj likuiditeti për të qenë në anën e sigurt.



Në anën e përparme, bankat po shohin sfidues në formë të bankave të internetit dhe të smartphone-ëve, dhe ofrues të pagesave alternative si PayPal dhe Amazon Pay.

Pra, bankat tradicionale janë nën presion si nga ana e përparme ashtu edhe nga ana e pasme përmes bankave novatore dhe sfiduese që nuk kanë barrën e sistemeve dhe proceseve të vjetra, por që mund të përqendrojnë biznesin e tyre në fusha ku bankat tradicionale kanë pasur monopol dhe ku marzhat ende janë mjaft interesante.

Për shumë nga problemet ekzistojnë zgjidhje të fjalës së fundit, të cilat ndihmojnë

**1** Përmirësimin e cilësisë së të dhënave

- 2** Disponueshmërinë e të dhënave në kohë reale
- 3** Ulin koston në mënyrë që kostoja për transaksion të bëhet konkurruese dhe mbulon pandjeshmërinë vëllimore në mënyrë që biznesi të mund të rritet pa nevojën e shtimit të stafit në të njëjtën normë
- 4** Zvogëlimin e gjasave për ndëshkim për shkak të çështjeve lidhur me raportimin rregulator dhe pajtueshmërinë në përgjithësi
- 5** Nxjerrjen e maksimumit nga kostot e parikuperueshme në sistemet ekzistuese që ndonjëherë është e vështirë të zëvendësohen



mirë do të mund të trajtohen proceset e varura siç janë menaxhimi i parasë dhe likuiditetit dhe raportimi rregullator.

Për shkak të mungesës së pozicioneve të kontrolluara për nga cilësia dhe mundësive në kohë reale, bankat janë të detyruara të mbajnë tamponë të mëdhenj të likuiditetit operativ në mënyrë që të jenë në gjendje të përballojnë detyrimet e tyre të pagesave. Sipas McKinsey Global Payments Map nga 2016 kjo arrin në mesatarisht 34% të kostos totale që një bankë ka për pagesat ndërkombëtare. Me PLUTO nga FBT, bankat kanë një sistem në kohë reale që integron të gjitha burimet e ndryshme që ndikojnë në pozicionet aktuale dhe të ardhshme të likuiditetit dhe u jep veglat e nevojshme për të minimizuar tamponët e tyre të likuiditetit operativ deri në 70% e më shumë. Kjo ka efekt pozitiv të drejtpërdrejtë në marzhat e bankës, pasi që kostoja zvogëlohet drejtpërdrejt. Kjo do të thotë gjithashtu që çmimi i transferimit të fondeve është zvogëluar, duke e bërë bankën më konkurruese në treg. Përveç kësaj, duke përdorur PLUTO bankat mund të përmbushin kërkesat rregulatore të përcaktuara në BCBS144, madje edhe në lidhje me aftësinë për të menaxhuar likuiditetin brenda ditës!

Elementi themelor prapa cilësisë së të dhënave është barazimi i kombinuar me automatizimin në mënyrë që shpejtësia e sanimit, kostoja operative dhe risku të jenë sa më të ulët. Zgjidhja ARO e EZOPS, duke qenë lider kur është fjala për kombinimin e barazimit të çfarëdo lloji të të dhënave me inteligjencën artificiale të testuar dhe të dëshmuar, arrin automatizimin inteligjent të proceseve që është fleksibel sepse përshtatet dhe mëson me ndryshimin e të dhënave.

Që të dy, PLUTO dhe ARO, lehtë mund të integrohen në peizazhin e sistemit ekzistues duke nxjerrë maksimumin nga kostot e parikuperuesh-

6

Fleksibilitetin për të trajtuar me lehtësi të dhënat e reja dhe proceset e reja

Përfitimet mund të korren duke zbatuar disa gjëra kyçe.

Së pari, mund të vendosen pikat e nevojshme të kontrollit të të dhënave në mënyrë që përjashtimet të mund të identifikohen dhe të trajtohen sa më shpejt që të jetë e mundur në ciklin jetësor të transaksionit ku kostoja e sanimit është më e vogla. Përdorimi i inteligjencës artificiale, si automati nxënës i pambikëqyrrur do të identifikojë anomalitë që mund të korrigjohen madje para se të kryhet barazimi.

Së dyti, automati nxënës i mbikëqyrrur, mund të ndihmojë në masë të madhe bankat që të ulin koston e hetimeve dhe menaxhimit e përjas-

htimeve. Automati nxënës do të mëson nga të dhënat historike dhe do të bënte parashikimin e tij me nivel të ndryshëm të besueshmërisë. Parashikimet e besueshmërisë së lartë do të mund të aktivizonin automatikisht përpunimin e mëtejshëm, pa përfshirjen e stafit operativ. Prandaj, ai zvogëlon koston dhe riskun e gabimeve njerëzore. Në të njëjtën kohë, stafi i bankës mund të përqendrohet në të gjitha përjashtimet me besueshmëri më ulët të parashikimit. Me kalimin e kohës, algoritmi i automatit nxënës bëhet më i trajtuar për transaksione dhe procese të reja, dhe së këndejmi mund të automatizohen gjithnjë e më shumë përpunime të përjashtimeve. Sa më shpejt që të ofrohet cilësi e lartë e të dhënave të transaksioneve, të dhënave të referencës dhe pozicioneve, aq më

## KËNDI I EKSPERTËVE

me që bankat tashmë i kanë realizuar në librat e veta. Prandaj, projektet e mëdha të zëvendësimit zakonisht nuk janë të nevojshme, që nënkupton se koha e implementimit të projektit është e shkurtër dhe risku i projektit është i ulët.

PLUTO është ndërtuar duke përdorur teknologji moderne të internetit. Bankat e interesuara për t'iu ofruar klientëve të tyre të korporatave shërbime të avancuara të menaxhimit të parasë, madje mund ta përdorin sistemin për të rritur të hyrat dhe pjesën e tregut. Meqenëse ky është një nga tregjet më konkurruese, mundësia për të ofruar shërbime të vlefshme, me funksionalitet që zakonisht është vetëm në dispozicion të bankave brenda vendit, mund të luajë rol të madh.

Nga ana e riskut, bankave u kërkohet të bëjnë stres teste të likuiditetit dhe parashikim të likuiditetit, siç është specifikuar në BCBS144 dhe BCBS248. Automati nxënës ARO mund të përdoret së bashku me PLUTO për të parashikuar pozicionet e ardhshme bazuar në të dhënat historike, rrjedhat e parasë dhe parametrat e njohur në të ardhmen. Kështu, parametrat e stres testit të përshkruara në dokumentacionin e BCBS248 mund të konfigurohen duke i ofruar bankës sistem të shkëlqyer për stres test të likuiditetit gjithashtu.

Pjesa më e madhe e kërkesave për raportim të viteve të fundit, qoftë në lidhje me likuiditetin (menaxhimi i likuiditetit brenda ditës, LCR, NSFR, etj.) ose raportimi i transaksioneve sipas EMIR, Dodd-Frank ose SFTR që do të implementohet në vitin 2020, janë kërkuese ndaj bankave, veçanërisht nëse kërkojnë përmbushjen e kërkesave të shumfishta të raportimit të tillë në juridiksione të ndryshme. Shumica e bankave kanë marrë qasjen e zgjidhjeve taktike për këtë problem. Ato kanë krijuar zgjidhjet e tyre specifike



FBT dhe EZOPS, që përdoren nga disa prej bankave prijëse në botë, janë pozicionuar në mënyrë të përkryer për të mbështetur bankat në kapërcimin e këtyre çështjeve, d.m.th. të vihen në pajtueshmëri rregullatore, të bëhen të zhdërvjellëta dhe të ulin koston, të menaxhojnë likuiditetin në mënyrë optimale dhe të bëhen më konkurruese.



për secilën prej tyre. Zgjidhjet shpesh përfshijnë shumë punë manuale, siç domos kur bëhet fjalë për kontrollin e të dhënave. EZOPS i ka ndihmuar bankat që të centralizojnë kontrollet e tilla në një monitor të vetëm dhe me përdorimin e automatit nxënës dhe automatizimin inteligjent të proceseve janë në gjendje të zvogëlojnë kohën operative me mbi 60% dhe saktësinë e raportimit me 50%. Kjo do të thotë që bankat minimizojnë riskun e mosraportimit të transaksioneve ose raportimit të transaksioneve që nuk parashihet të raportohen. Raportimi i gabuar ose keqraportimi i tillë mund të shkaktojë që mbikëqyrësit të penalizojnë ndjeshëm bankat.

Për ta përmbledhur, bankat në përgjithësi hasin në disa probleme që shkaktojnë kokëçarje të natyrës operative, të pajtueshmërisë, likuiditetit dhe konkurrencës. FBT dhe EZOPS, që përdoren nga disa prej bankave prijëse në botë, janë pozicionuar në mënyrë të përkryer për të mbështetur bankat në kapërcimin e këtyre çështjeve, d.m.th. të vihen në pajtueshmëri rregullatore, të bëhen të zhdërvjellëta dhe të ulin koston, të menaxhojnë likuiditetin në mënyrë optimale dhe të bëhen më konkurruese.

**KATERINA BOSEVSKA**

Drejtoreshë Menaxhuese  
EOS Matrix-Maqedoni, Kosovë & Mali i zi

# Të drejtat e individëve kundrejt detyrimeve të tyre ndaj kontrollorëve të të dhënave personale

**E** dhënë personale konsiderohet çdo informacion lidhur me një person fizik (i quajtur subjekt i të dhënave), që mund ta identifikojë atë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Mund të jetë çdo informacion që është unik për individin ose informacion që nuk është unik për individin, por që i kombinuar me një informacion tjetër mund të na çojë në identifikimin e individit.

Ka shumë kategori të ndryshme të të dhënave personale. Në ditët e sotme, ndër ato më interesantet janë të dhënat personale digjitale, të cilat përfshijnë email-at, llogaritë dhe postet në media sociale, metadata si dhe në disa raste, adresa IP. IP adresat konsiderohen si të dhëna personale vetëm në disa raste, duke pasur parasysh se adresa IP mund të jetë dinamike dhe adresa të ndryshme IP mund të caktohen çdo herë që pajisja lidhet me internetin.

Teksa teknologjia po përparon vazhdimisht dhe inteligjenca artificiale po bëhet e ardhmja e teknologjive të informacionit, mbrojtja e të dhënave personale bëhet gjithnjë e më e rëndësishme nga dita në ditë. Është shumë me rëndësi të pranojmë se kategoria digjitale e të dhënave personale është duke u bërë e ardhmja e mbrojtjes së të dhënave, edhe



**DIREKTIVA PËR  
MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE, E PARA E KËTIJ  
LLOJI PËR RREGULLIMIN  
E PËRPUNIMIT TË TË  
DHËNAVE PERSONALE  
BRENDA BASHKIMIT  
EVROPIAN, U ADOPTUA  
NË VITIN**

# 1995


pse kategoritë e tjera nuk janë më pak domethënëse.

Direktiva për Mbrojtjen e të Dhënave, e para e këtij lloji për rregullimin e përpunimit të të dhënave personale brenda Bashkimit Evropian, u adoptua në vitin 1995. Në mes të Direktivës për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave, Mbretëria e Bashkuar miratoi Aktin e Mbrojtjes së të Dhënave në vitin 1998. Duke filluar nga viti 1998, deri në vitin 2000, u hartuan Parimet e Privatësisë Safe Harbor, të cilat ia

mundësuan kompanive të Shteteve të Bashkuara që të respektojnë Direktivën për Mbrojtjen e të Dhënave, me qëllim të parandalimit të zbulimit aksidental të të dhënave nga organizatat që ruajnë të dhënat personale brenda BE-së dhe SHBA-së. Në vitin 2016, u hartua kuadri i Mburjes së Privatësisë BE-SHBA, që i ofron kompanive bashkëpunuese nga BE-ja dhe SHBA-ja mekanizmin për respektimin e Direktivës për Mbrojtjen e të Dhënave gjatë transferimit të të dhënave personale nga njëri kontinent në tjetrin.

Në ditët e sotme, komunikimi po tkurret në suazat e rrjeteve sociale. Komunikimi zyrtar përmes postës së shtypur gjithnjë e më shumë po zëvendësohet me postë elektronike. Njerëzit blejnë dhe paguajnë online dhe as që po përdorin para të vërteta. Teksa blerja online po bëhet më tërheqëse për njerëzit që nuk kanë kohë për të shkuar nëpër dyqane, gjithashtu edhe marketingu sipas sjelljes është në rritje. Gjithkush ka portofol online dhe krypto-valutat gjithashtu po bëhen shumë të popullarizuara. Njerëzit po investojnë në shtëpi të mençura, të cilat përdorin shenjat e gishtërinjve dhe njohjen e fytyrës për të ofruar shërbime të cilat e bëjnë jetën më të lehtë. Në mes të të gjitha këtyre përfitimëve që i kemi nga përdorimi i teknologjisë, ne po i kushtojmë gjithnjë e më pak vëmendje asaj se nga cilat pasuri jo materiale, të tilla si të dhënat personale, ne po heqim dorë, për hir të përdorimit të këtyre shërbimeve.

Ndërkohë që kompanitë kanë nevojë për më shumë të dhëna për të zbatuar dhe përmirësuar shërbimet e tyre, dhe përpunimi i të dhënave personale me inteligjencë artificiale kërkon performanca më të mira dhe procesorë më të shtrenjtë, po bëhet më e leverdishme për kompanitë që të ruajnë dhe të përpunojnë të dhënat personale në cloud në vend se të blejnë serverë dhe të ndërtojnë dhoma të serverëve të cilat i përmbushin të gjitha kërkesat për siguri të serverëve dhe të dhënave personale. Duke qenë se njerëzit nuk dinin se ku



gjenden dhe si përpunohen të dhënat e tyre personale, lindi nevoja për ligj të ri, kështu që autoritetet filluan të punonin në Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave, e cila u prezantua dhe hyri në fuqi në 2016.


Dallimi midis një "direktive" dhe një "rregulloreje" në kuptim të legjisllacionit të BE-së është se direktivat nuk janë të zbatueshme drejtpërdrejt në të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së, pasi që ato vendosin vetëm standardet minimale dhe Shtetet Anëtare të BE-së duhet të krijojnë legjisllacionin e vet për t'i plotësuar ato standarde. Së këndejmi, direktivat kërkojnë masa zbatimi në të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së dhe i japin secilit anëtar fleksibilitetin për të zbatuar direktivat në çfarëdo

mënyre që i përshtatet atyre.

Rregulloret ekzistojnë si ligje në vete, duke zëvendësuar çdo ligj relevant të miratuar nga Shtetet Anëtare. Ato zbatohen në mënyrë konsistente në të gjitha Shtetet Anëtare. Nëse ka mundësi për variacione lokale, ajo identifikohet shprehimisht në tekstin e Rregullores. Prandaj, Rregulloret paraqesin mekanizëm efektiv për zbatimin e një qasjeje konsistente për 511 milionë njerëz në 28 Shtete Anëtare.

Shtetet Anëtare kishin dy vjet për të siguruar që Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave është plotësisht e zbatueshme në vendet e tyre dhe organizatat kishin afat deri në maj 2018 për të filluar ta respektojnë atë.

Qëllimi i Rregullores së Përgjithshme



panitë do të raportojnë te një autoritet i vetëm për mbrojtjen e të dhënave, pavarësisht nga numri i Shteteve Anëtare në të cilat ato veprojnë.

Meqë Republika e Maqedonisë së Veriut ende nuk është Shtet Anëtar, të gjitha organizatat nuk e kanë obligim ta respektojnë rregulloren, por vetëm ato që përpunojnë të dhënat personale të qytetarëve të Bashkimit Evropian. Propozimi i ligjit tashmë është bërë, kështu që është vetëm çështje kohe se kur do të shpallet dhe qytetarëve të Maqedonisë do t'u jepen të njëjtat të drejta si qytetarëve të Bashkimit Evropian. Pastaj do të bëhet e pashmangshme për të gjitha kompanitë që të veprojnë në përputhje me të, në mënyrë që të ruajnë konkurrueshmërinë e tyre në treg.

Nga njëra anë, rregullorja parasheh mbrojtjen e të dhënave personale të subjektit të të dhënave, si të drejtë themelore të tyre. Për të kontribuar në këtë aspekt, rregullorja i lejon subjektet e të dhënave të ushtrojnë të drejtat e tyre, siç janë:

- ▷ E drejta e qasjes
- ▷ E drejta e korrigjimit
- ▷ E drejta e kufizimit të përpunimit
- ▷ E drejta e portabilitetit të të dhënave
- ▷ E drejta e kundërshtimit të përpunimit
- ▷ E drejta e fshirjes

Nga ana tjetër, kompanitë që shfaqen si kontrollorë të të dhënave personale duhet të ndjekin parimin e llogaridhënies dhe të jenë në gjendje të demonstrojnë pajtueshmërinë me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtje të të Dhënave.

Kontrollorët do të jenë përgjegjës për të demonstruar se kujdesen për të dhënat personale të subjekteve të të dhënave. Ata duhet të zbatojnë rregullisht analizën e riskut, si dhe masat e duhura për minimizim të riskut. Në rast të shkeljes së privatësisë së të dhënave, duhet të informohen autoritetet dhe varësisht nga vëllimi i të dhënave që janë zbuluar, në disa raste duhet të informohen edhe subjektet e

për Mbrojtje të të Dhënave është:

- ▷ eliminimi i mospërputhjeve në ligjet kombëtare - rregullimi është pak a shumë i njëjtë në të gjitha Shtetet Anëtare, siç u përmend më lart;
- ▷ përditësimi i ligjit për të adresuar më mirë sfidat bashkëkohore të privatësisë
- ▷ ofrimi i mbrojtjes më të mirë të të dhënave për individët
- ▷ zvogëlimi i ngarkesave të kushtueshme administrative për kompanitë që kanë shërbime në disa Shtete Anëtare - ato do të duhet të merren me një autoritet në vend se me më shumë prej tyre, meqë Mbrojtja e të Përgjithshme e të Dhënave është "shërbim me një ndalesë të vetme" dhe të gjitha kom-



**Në ditët e sotme,  
komunikimi po tkurret në  
suazat e rrjeteve sociale.  
Komunikimi zyrtar përmes  
postës së shtypur gjithnjë e  
më shumë po zëvendësohet  
me postë elektronike.**



të dhënave. Në raste të tilla, kompanitë marrin risk të madh për shkatërrim të reputacionit.

Për të qenë në pajtueshmëri me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave dhe për të ruajtur reputacionin e vet, kompania duhet të jetë mjaft transparente dhe të ofrojë informata se si, ku dhe pse po zhvillohet përpunimi, në formë të thukët dhe të kuptueshme.

Një nga parimet më sfiduese që kontrollorët duhet ta përmbushin është që të sigurojnë se të dhënat personale që po i përpunojnë janë të sakta. Shumë kërkime tregojnë se një përqindje shumë e vogël e njerëzve i lexojnë kontratat që i nënshkruajnë (përpara se t'i nënshkruajnë) dhe politikat e privatësisë të cilat ata po i pranojnë (përpara se t'i pranojnë ato), kështu që ata as që janë të vetëdijshëm për:

- ▷ Detyrimet që po i pranojnë;
- ▷ Nëse e kanë detyrim të përditësojnë të dhënat e tyre personale në një kohë të arsyeshme pas ndryshimit të tyre;
- ▷ Nëse po e lejojnë kontrollorin që t'ia transferojë të dhënat palëve të treta;
- ▷ Cilat janë rastet kur ata mund të kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e tyre për



**Të dhënat personale janë identiteti i individit. Ndërsa kompanitë duhet t'i mbrojnë ato, gjithashtu edhe individët kanë detyrimin që të jenë të vetëdijshëm për rreziqet dhe keqpërdorimin e mundshëm. Çelësi dhe fuqia qëndrojnë te edukimi i vazhdueshëm.**

kufizimin e përpunimit, apo edhe fshirjen e të dhënave personale?

Individët e kanë obligim përditësimin e të dhënave të tyre personale sapo të ndryshojnë ato, por që kjo pothuajse nuk ndodh kurrë në realitet. Kjo na bën të pyesim veten:

- ▷ A mbrohen mjaftueshëm interesat e kompanisë?
- ▷ Nëse, me adoptimin e Rregullores, qytetarët do të jenë të obliguar të korrigojnë të dhënat e tyre personale në kompanitë ku ata ende kanë disa detyrime?
- ▷ A do të ketë ndonjë mënyrë për të kontrolluar nëse qytetarët po i përmbushin detyrimet e tyre, pasi që do të ketë një mënyrë për të kontrolluar nëse kompanitë po i përmbushin detyrimet e tyre?
- ▷ Në fund të fundit, a jemi ende gati që ta adoptojmë Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave?

Rregullorja nuk duhet të ndalë kompanitë nga ofrimi i shërbimeve të tyre dhe duhet të edukojë qytetarët që në vend që vetëm të kërkojnë të ushtrojnë të drejtat e tyre, dhe të presin që kompanitë të përmbushin detyrimet e tyre, edhe ata gjithashtu duhet të përmbushin detyrimet e tyre.

Pa dyshim, kjo temë do të mbetet tejet e rëndësishme në të ardhmen dhe do të prekë jetën e individëve, si dhe proceset e biznesit. Megjithatë, nuk duhet harruar se arsyeja e nevojës për të përmirësuar ligjin ekzistues për mbrojtjen e të dhënave është pikërisht nevoja e qytetarëve për të përdorur shërbimet e kompanive që me sa duket janë kontrollore të të dhënave të tyre personale. Gjithsesi, ky është njëfarë lloj “rrethi vicioz”.

Të dhënat personale janë identiteti i individit. Ndërsa kompanitë duhet t'i mbrojnë ato, gjithashtu edhe individët kanë detyrimin që të jenë të vetëdijshëm për rreziqet dhe keqpërdorimin e mundshëm. Çelësi dhe fuqia qëndrojnë te edukimi i vazhdueshëm.

**AKIL NDRENIKA**Drejtor i Sigurisë së Informacionit  
PayLink

# Siguria e përdorimit të kartelave në internet

Në vjeshtë të vitit 2019 hyn në fuqi versioni i ri 2.0 EMV 3-D Secure për blerjet e sigurta online - card not present- CNP-, për të gjitha transaksionet e kryera online. Për tregun evropian ky zhvillim i ri në këtë fushë ndihmon tregtarët me përputhshmërinë me PSD2 SCA “strong customer authentication” sipas BE. Brandet ndërkombëtare të kartave kanë përgatitur një version të ri të standardit të sigurisë EMV® 3-D Secure të blerjeve online, të cilën mund ta keni ndeshur deri tani në versionin 1.0 me termat MasterCard Secure Code apo Verified by Visa.

Versioni i ri ka marrë parasysh kërkesat dhe nevojat e tanishme dhe të ardhshme të tregut. Aktorët kryesorë të industrisë së kartave e kanë vlerësuar rëndësinë për të pasur një version të ri të standardit, i cili do të mund të mundësojë autentikimin bazuar në aplikime “app-based auth” gjithashtu dhe integrimin e digital wallets, sikurse dhe transaksionet e-commerce të kryer nga browser-pc. Të gjithë këto ndikuan në zhvillimin e versionit 2.0 të standard 3-D Secure. Specifikimet e reja marrin parasysh kanalet e reja të pagesave në ditët e sotme si dhe përmirësojnë dukshëm performancën, lehtësinë në përdorim nga klienti, si dhe duke ofruar siguri lider në industrinë e kar-



Konsumatorët shqetësohen më të drejtë kur nuk u ofrohet një blerje e sigurt dhe po aq e lehtë për tu kryer në çdo ndërveprim online. Jemi në një pikë kur kemi teknologji dhe dije mjaftueshëm për të përjashtuar çdo shqetësim gjatë blerjeve të sigurta online me standardin 2.0 të EMV 3D-Secure.

tave. EMV® 3-D Secure (3DS) është një protokoll që mundëson autentikim të klientit dhe i mundëson klientëve të autentifikohen me “card issuer” të tyre kur bëjnë transaksion “NP” card not present. Shtresa e shtuar e sigurisë ndihmon në parandalimin e transaksioneve CNP të paautorizuara si dhe ndihmon në mbrojtjen e tregtarit nga fraudi i transaksioneve CNP. Në fakt, version 1.0 kishte hapa në proces të cilat nuk e lehtësonin konsumatorin të kryente blerjet online të sigurta thjeshtë. Shumë konsumatorë dekurajoheshin dhe në shumë raste e linin blerjen në mes pa e përfunduar atë.

Çasti përfundimtar në blerjet online është kur secili prej nesh klikon apo prek-tap dhe transaksioni kryhet. Askush nuk dëshiron një refuzim dhe për më tepër një refuzim i veprimit që vjen si pasojë e elementeve të sigurisë që nuk janë të implementuara për të mbrojtur konsumatorin. Ky refuzim është po aq negativ sa edhe humbjet për shkak të fraud, për arsye se kur ndodh ky refuzim, konsumatori jo vetëm që lë blerjen në mes, por krijon një perceptim të gabuar për kartën duke mos e përdorur më atë për blerjet online. “False decline” apo refuzime të gabuara përllëgariten në qindra milion euro në të ardhura të munguar kryesisht në BE.

Blerjet në POS -card present në dyqane, butikë, hotele etj., janë bërë më të sigurta me kalimin e kohës, ndërsa në të njëjtën kohë fraud online është në rritje. Arsyeja është e thjeshtë, për shkak të verifikimit të identitetit të konsumatorit, i cili mbetet një sfidë për konsumatorin dhe tregtarin online – merchant. Përllëgaritet që rreth 50% e transaksioneve online të kenë një risk të lartë për vjedhje të identitetit apo për përdorim keqdashës të kredencialeve.

Konsumatorët shqetësohen me të drejtë kur nuk u ofrohet një blerje e sigurt dhe po aq e lehtë për tu kryer në çdo ndërveprim online. Jemi në një pikë kur kemi teknologji dhe dije mjaftueshëm për të përjashtuar çdo shqetësim gjatë blerjeve të sigurta online me standardin 2.0 të EMV 3D-Secure.

Ndoshta është i komplikuar si term për të shpjeguar një gjë shumë të thjeshtë, por ky është një standard i ri në industrinë e kartave për të siguruar identitetin e konsumatorit në transaksionet digjitale të pagesave online. Me implementimin e versionit 2.0 EMV 3D-Secure, brendet ndërkombëtare të kartave kanë krijuar programet e tyre. Ky është një program që u mundëson tregtarëve dhe bankave një rrugë të lehtë për të përditësuar dhe zgjeruar sigurinë e tyre,

për të vlerësuar drejt risqet e mundshme dhe për të siguruar që transaksionet janë aprovuar në mënyrë të sigurtë dhe pa vështirësi për konsumatorin.

Duke përdorur këto programe, inteligjencën artificiale dhe machine learning, standardi EMV 3D-Secure versioni 2.0, merr në konsideratë rreth 150 variabla dhe parametra të një transaksioni për të ndihmuar bankën (issuer) - lëshuese të kartave, për të marrë një vendim më të saktë, më të plotë më me shumë të dhëna në dispozicion, për të aprovuar një transaksion online ose për ta refuzuar atë. Version 2.0 ofron një vendimarrje më të plotë më të saktë dhe më cilësor për bankën issuer- lëshuese të kartës. Këto parametra, ndryshore apo variabla, përfshijnë faktorë të ndryshëm si për shembull: gjestikulacioni i caktuar i një konsumatori në smar-



## 3DS

EMV® 3-D Secure (3DS) është një protokoll që mundëson autentikim të klientit dhe i mundëson klientëve të autentifikohen me “card issuer” të tyre kur bëjnë transaksion “CNP” card not present.



## VEÇORITË KRYESORE TË 2.0 JANË :

- Mundëson blerjet app-based në telefonat celularë dhe në pajisje të tjera mobile të konsumatorit;
- Përmirëson përvojën e klientit në blerjet e sigurta online CNP duke mundësuar vendimmarrje inteligjente mbi vlerësimin e riskut duke mundësuar autentifikime të sigurta dhe të thjeshta;
- Ofron siguri të lartë për pagesat online;
- Mundëson zgjidhje të ndryshme si për autentifikimin e shumëfishitë duke përfshirë fjalëkalime një përdorimshe FNP, apo dhe autentifikim biometrik;
- Zgjeron funksionalitetin për tregtarët të cilët mund të integrojnë procesin e autentifikimit gjatë procesit të checkout, si për rastet e blerjeve app based dhe browser based;
- Ofron përmirësime të performancës nga fillimi në fund të blerjes së sigurtë online;
- Shton një kategori mesazhi të ri për të mundësuar verifikimin e kartë mbajtësit gjatë veprimeve me kartë por pa pagesë si p.sh.: shtimi i kartës në një kuletë digjitale;
- Mundëson verifikim të llogarisë nisur nga tregtari online – Merchant;
- Versioni 2.0 është i hapur për të gjithë pjesëmarrësit dhe publikun.

### Shënim:

Ky shkrim është bazuar mbi materiale dhe informacione të marra nga website të EMV Co, Mastercard dhe Visa.

tphone, duke qenë se secili prej nesh ka një patern-model të caktuar gjestesh si e përdor celularin, rrotullon, mban, etj., historiku i blerjeve online, oraret e blerjeve, apo dhe ndriçimi që përdor konsumatori në celular apo kompjuter gjatë blerjeve online së bashku me informacione të tjera nga tregtari dhe banka lëshuese e kartave – issuer bank, këto të dhëna përdoren për të autentikuar një transaksion online. Në rastet kur nevojitet autentikim shtesë për të mbrojtur konsumatorin mund të ofrohet identifikimi biometrik apo me fjalëkalime një përdorimësh - One Time Password. Pra, version 2.0 ofron një mënyrë më të thjeshtë për të vërtetuar online që personi që kryen veprimin është personi zotërues i kartës (“you are you”).

E gjithë kjo ndodh në fraksion të kohës për konsumatorin. Implementimi i zgji-

dhjeve të sigurisë kaq praktik dhe pa krijuar shqetësim për konsumatorin është kritikë për të pasur në vazhdimësi një marrëdhënie besimi tre palëshe mes bankës, tregtarit dhe konsumatorit. Në kohën e ekonomisë digjitale, shoqërisë së informacionit, ky standard 2.0 bën të mundur një përvojë të njëjtë, të thjeshtë dhe praktike për përdoruesin si në kompjuter, tablet, celular apo në çdo mjet tjetër të përdorur për blerjet online.

Bankat dhe tregtarët online kanë një besim më të madh në blerjet online kur identiteti i konsumatorit është i vërtetuar, duke sjellë një rritje të transaksioneve të aprovuara, me pak refuzime të gabuara.

Versioni 2.0 bën të mundur rritjen e besimit, tregtarë-bankë dhe konsumator të kënaqur.

# Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit për ngritjen e sigurisë në sektorin bankar

Kryeshefi Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Petrit Balijska ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrin e Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, Drejtorin e Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj dhe Guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës z. Fehmi Mehmeti. Kjo marrëveshje u nënshkrua si rezultat i takimeve të mëhershme të zhvilluara me përfaqësues të këtyre institucioneve, në të cilat u diskutua për shqetësimet rreth dukurisë së plaçkitjes së institucioneve financiare në Kosovë. Marrëveshja ka për qëllim avancimin e bashkëpunimit për ngritjen e nivelit të sigurisë në sektorin bankar në mënyrë që bankat, personeli i tyre dhe qytetarët të kenë një ambient sa më të sigurt për

zhvillimin e aktivitetit të tyre. Me këtë rast, Guvernatori Mehmeti ka falënderuar institucionet e angazhuara në arritjen e kësaj marrëveshjeje për bashkëpunimin dhe masat e ndërmarra me qëllim të ofrimit të një ambienti më të sigurt për institucionet financiare që operojnë në Kosovë.



## Shoqata e Bankave të Kosovës ndan Çertifikatë mirënjohjeje për EFSE dhe EFSE DF, këshilluar nga Finance in Motion



Shoqata e Bankave të Kosovës i ka dhënë certifikatë mirënjohjeje Fondit Evropian për Evropë Juglindore (EFSE) dhe EFSE për Zhvillim Fasilitues (EFSE DF), këshilluar nga Finance in Motion GmbH, për përkrahjen e madhe që e ka dhënë në publikimin e revistës “The Kosovo Banker” për gjashtë vite me radhë prej 2013 deri më 2018. “The Kosovo Banker” është publikim i Shoqatës së Bankave të Kosovës e cila botohet dy herë në vit me qëllim të informimit adekuat të publikut për industrinë bankare në Kosovë. EFSE DF ka përkrahur botimet e viteve prej 2013 deri



## Si ta menaxhojmë rrezikun operacional në Banka

Shoqata e Bankave të Kosovës në bashkëpunim me House of Training/ ATTF dhe përkrahur nga Qeveria e Luksemburgut organizuan trajnimin tre (3) ditorë me temë: "Operational Risks and Controls frameworks", të udhëhequr nga Ztr. David Richards, i cili me përvojën e tij mbi 24 vjeçare në shërbimet e sektorit financiar, solli para të pranishmëve çasje të re karshi koncepteve të avancuara dhe teknikave për menaxhimin e rrezikut operacional dhe implementimin e një kuadri të përhershëm të kontrollit si

pjesë e kontrollit të brendshëm dhe parimeve të auditimit të brendshëm.

Përmes këtij trajnimi, pjesëmarrësit patën rastin të analizojnë shkatërrtarët e rrezikut operacional, të diskutojnë skenarë dhe komponentë të ndryshme, aspektet organizative dhe konceptet kyçe të rrezikut operacional duke përfshirë edhe kornizën e kontrollit dhe menaxhimin e këtyre rreziqeve. Përmes diskutimeve grupore, pjesëmarrësit shkëmbyen përvojat e tyre duke gërshtuar kështu teorinë me praktikën.



2018, duke ndihmuar në publikimin dhe në shpërndarjen e saj tek publiku i gjerë pa pagesë. Përkrahja e tyre e çmuar ka kontribuar shumë në ngritjen e edukimit financiar për publikun e gjerë të Republikës së Kosovës. Gjatë kësaj periudhe, 12 botime me afërsisht 10 mijë kopje fizike për çdo numër të saj me tema dhe përmbajtje të ndryshme janë shtypur, duke filluar nga diskutimet e nivelit të lartë financiar deri tek ato me koncepte më bazike financiare dhe bankare. Kryeshefi Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Z. Petrit Balija, theksoj: "EFSE DF ka qenë një

partner i rëndësishëm gjate viteve, jo vetëm në përkrahjen e këtij projekti, mirëpo duke bashkëpunuar me ne në shumë aktivitete të ndryshme të cilat kanë kontribuar në edukimin financiar si dhe në rritjen e qasjes në financa." Revista është një nga publikimet më të mëdha të Shoqatës së Bankave dhe ka fituar lexues dhe partner gjatë gjithë këtyre viteve, përfshirë këtu edhe bankat komerciale të cilat e kanë përkrahur këtë publikim. Përfaqësuesja e Finance in Motion në Kosovë, Znj. Venera Hoxha, theksoj: "Për EFSE DF është një nder i veçantë për të pranuar këtë

mirënjohje prej Shoqatës së Bankave të Kosovës. Ka qenë gjithashtu kënaqësi për të bashkëpunuar dhe përkrahur "The Kosovo Banker" gjatë viteve, duke kontribuar kështu në ngritjen e nivelit të edukimit financiar ndërmjet akterëve të sektorit financiar si dhe tek publiku i gjerë. Ne kemi për qëllim që të vazhdojmë këtë bashkëpunim të frytshëm përmes projekteve dhe aktiviteteve tjera në të ardhmen." Revista "The Kosovo Banker" do të vazhdoj të jetë një nga kanalet kryesore të informimit nga sektori bankar për publikun e gjerë në Republikën e Kosovës.



## Sektori bankar mbështet zhvillimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore

Kryeshefi Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Z. Petrit Balija ka marr pjesë në panelin e konferencës së Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, me rastin e përvjetorit të tretë të lansimit zyrtar të institucionit të FKGK-së si dhe me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes së garan-

cisë ndërmjet Fondit Investues Evropian lidhur me Programin e Unionit Evropian për NVM-të COSME. Z. Balija ka thënë se bankat komerciale kanë mbështetur krijimin dhe zhvillimin e Fondit i cili ka ndikuar pozitivisht në rritjen e qasjes në financa të NVM-ve. Sektori bankar do të

vazhdojë të jetë përkrahës i Fondit për të arritur suksese të reja edhe në të ardhmen. Me këtë rast, në emër të sektorit bankar, Z. Balija ka përgëzuar Bordin dhe menaxhmentin e Fondit si dhe institucionet e tjera që kanë mbështetur themelimin, zhvillimin dhe mbikëqyrjen e Fondit.

### SHBK ORGANIZOI TRAJNIMIN MBI PROCESIN E LIGJ-BËRJES NË KOSOVË

Shoqata e Bankave të Kosovës organizoi trajnimin mbi Procesin e Ligj-bërjes në Kosovë. Qëllimi i këtij trajnimi ishte prezantimi i kornizës ligjore dhe institucionale në procesin e hartimit dhe koordinimit të politikave dhe ligj-bërjes në Kosovë. Pjesëmarrësit u informuan në lidhje me fazat e procesit të hartimit të ligjeve dhe rolin e institucioneve në këtë proces.



## Mbahet takimi i nivelit të lartë të sektorit bankar të Kosovës

Sot është mbajtur takimi gjysmë-vjetorë i nivelit të lartë në mes të Bankës Qendrore të Kosovës dhe Shoqatës së Bankave të Kosovës. Në këtë takim u diskutua për çështjet më të rëndësishme të sektorit bankar me theks të veçantë në çështjet që kanë të bëjnë me rritjen e qasjes në financa apo kreditim për bizneset e vogla dhe të mesme si dhe për rritjen e qasjes në llogari bankare për individë. Në takim u diskutuan edhe objektivat e përbashkëta për të siguruar stabilitet të

sektorit bankar përfshirë edhe legjislacionin bankar dhe kushtet e përgjithshme të ofrimit të shërbimeve bankare në Kosovë. Në takim u konstatua që dialogu konsultativ në mes të gjithë pjesëmarrësve në sektorin financiar është me rëndësi të veçantë për të siguruar që kemi stabilitet financiar, respektim të të drejtave të konsumatorëve financiar si dhe të vazhdojmë të rrisim kontributin për një zhvillim më të madh ekonomik të Kosovës.



## Mbahet trajnimi në “Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS)”

Sot përfundoi me sukses trajnimi i mbajtur me temën “Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS)” i organizuar nga Shoqata e Bankave të Kosovës në partneritet me House of Training të ATTF nga Luksemburgu dhe mbështetur nga Qeveria e Luksemburgut. Trajnimi u ligjërua nga konsulenti me përvojë ndërkombëtare z. Robert Hall, përderisa pjesëmarrësit në trajnim ishin nga bankat komerciale, Banka Qendrore e Kosovës, institucionet mikrofinanciare si dhe nga institucionet e tjera financiare. Ky trajnim kishte për fokus standardin e IFRS 9 i cili shumë shpejt pritet të jetë i zbatueshëm edhe në Kosovë. Shoqata e Bankave të Kosovës vazhdon të jetë promotor i ndërtimit të kapaciteteve njerëzore në sektorin financiar të Kosovës.



## SHBK organizoi punëtorinë mbi Ligjin për Bankat



Shoqata Bankave të Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët e saj nga sektori bankar, organizoi punëtorinë njëditore për të diskutuar komentet preliminare mbi Ligjin për Bankat. Në punëtori morën pjesë profesionistë të sektorit bankar për të diskutuar propozimet për ndryshimin e ligjit aktual nr. 04 / L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo bankare, i cili pritet të ndahet në dy ligje, respektivisht një ligj i veçantë për bankat, ndërkohë që institucionet financiare mikrofinanciare

dhe jo-bankare do të kenë një ligj tjetër që rregullon ato. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte përgatitja e shkresës së komenteve të SHBK mbi përmirësimin e ligjit për bankat në mënyrë që të ketë rritje të stabilitetit të sektorit bankar, zvogëlimin e pengesave për funksionimin e bankave dhe rritjen e qasjes në financa për qytetarët dhe bizneset në Kosovë. Punëtorja u mbajt në vazhden e diskutimeve të vazhdueshme me rregullatorët, ministritë dhe ligjberësit që pritet të bëhen më dinamike në muajt e ardhshëm.

# Vlerësohet kontributi i veçantë i Anëtarit të Bordit Alper Karakoç

Kryeshefi Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK), Ztr. Petrit Balija priti sot Drejtorin e Degës në Kosovë të Iş-Bank, njëherazi anëtarin e Bordit të Drejtorëve të SHBK-së, Ztr. Alper Karakoç i cili përfundon mandatin e tij në Kosovë. Me këtë rast, në emër të Bordit të Drejtorëve të Shoqatës së Bankave të Kosovës, Kryeshefi Ekzekutiv Ztr. Balija i ndau mirënjohje për kontribut të veçantë si anëtar i Bordit të Drejtorëve të SHBK-së.

Ztr. Balija, falënderoi Ztr. Karakoç për angazhimin dhe kontributin e tij ndër vite për Shoqatën e Bankave të Kosovës dhe zhvillimin e një banke të re në Kosovë sikurse IS Bank, duke dhënë kështu kontribut të rëndësishëm edhe për avancimin e pozitës së sektorit bankar dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë.



## Si t'i luftojmë mashtrimet në industrinë bankare

Shoqata e Bankave të Kosovës në bashkëpunim me Albanian Institute of Internal Auditors (AIIA) përfunduan me sukses trajnimin dy ditor: “Managing the Threat from Fraud”, të udhëhequr nga Ztr. Bob Pointer, i cili me përvojën e tij mbi 30 vjeçare si hetues, intervistues, konsulent dhe lektor solli para të pranishmëve teknika të reja të adoptimit të një sistemi i cili ndihmon në parandalimin, zbulimin, përcaktimin e sasisë dhe reagimin ndaj kërcënimeve të mashtrimit.

Përmes këtij trajnimi, pjesëmarrësit patën rastin të krijojnë një pamje të qartë të krimit të tanishëm financiar në industrinë bankare, ku përmes punës interaktive dhe diskutimeve grupore, shqyrtuan mundësitë e parandalimit të rrezikut nga mashtrimi. Gjatë këtij trajnimi, u potencua se ka shumë modele që përdoren për të profilizuar një mashtrues të brendshëm ndërsa u theksua se çdokush ka aftësinë për të shkaktuar dëme në një organizatë me ose pa dashje. Përvoja



ndërkombëtare e Ztr. Bob Pointer, i cili ishte i përfshirë në disa raste hetimi të mashtrimit me qytetin e Policisë së Londrës, forcën kryesore të Mbretërisë së Bashkuar, mundësoi që pjesëmarrësit e këtij trajnimi të përvetësojnë aftësi të vlefshme në zbutjen e rrezikut qoftë nga burimet e jashtme apo edhe ato të brendshme

# Zgjedhet Bordi i ri i Shoqatës së Bankave të Kosovës



## Shoqata e Bankave përzgjedh shkollat që do të përfitojnë nga programi i Javës Ndërkombëtare të Parasë -2019

Shoqata e Bankave të Kosovës në kuadër të aktiviteteve të saja edukativo-financiare do të organizoj programin e Javës Ndërkombëtare të Parasë 2019 me temë MËSO. KURSE.FITO ku nga data 25 mars do të bëjë shpërndarjen e pakove me materiale edukative për fëmijë. Nga data 25 mars, Shoqata e Bankave të Kosovës do të bëjë shpërndarjen e pakove me materiale edukative për fëmijë në tetë (8) komuna të Kosovës përfshirë Prishtinë, Ferizaj, Gjakovë, Mitrovicë, Pejë, Istog, Podujevë dhe Vushtrri. Në këto tetë (8) komuna janë përzgjedhur shkollat fillore ku do të ligjërohet në 16 klasë për nxënës të klasës së katërt dhe pestë, me një pjesëmarrje prej 1440 nxënësve. Kryeshefi Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Petrit Balijska tha se "Me këto aktivitete, Shoqata e



Bankave të Kosovës synon që të angazhojë fëmijët dhe të rinjtë për të mësuar më shumë për financat, duke përfshirë këtu kursimet, menaxhimin e parasë, menaxhimin e financave personale etj. Këto aktivitete mbështeten dhe financohen nga bankat komerciale të Ko-

sovës të cilat kanë për qëllim që të fuqizojnë shoqërinë përmes edukimit financiar." Gjatë kësaj jave fëmijët do të kenë aktivitete të ndryshme, si plotësimin e librit të kursimeve, punime dore dhe vizatime në lidhje me paratë dhe kursimet.



## Gjatë muajit prill u mbajt Chopin Piano Fest Prishtina 2019

Chopin Piano Fest Prishtina 2019 përkrahet nga banka Raiffeisen për vitin e 10-të me radhë. Për shkak të suksesit dhe vlerësimit të madh nga audiencia në Kosovë, festivali është shndërruar në një festival tradicional. Festivali promovon muzikën e pianos dhe performancën në piano por shërben gjithashtu si një platformë e shkëlqyeshme për shkëmbim në mes të Kosovës dhe muzikantëve ndërkombëtarë. Edicioni i 10-të Chopin Piano Fest Prishtina 2019 mbledhi si gjithmonë pianistë vendorë dhe ndërkombëtarë të cilët performuan jo vetëm veprat e Chopin, por edhe të kompozitorëve të tjerë të mirënjohur, klasikë dhe bashkëkohorë.



## Banka Raiffeisen mbështet ATOMIN

Banka Raiffeisen mbështet projektin ATOMI për vitin e tetë me radhë. Instituti ATOMI ka për qëllim identifikimin dhe përkrahjen e personave me inteligjencë të jashtëzakonshme, me dhunti e talente në Kosovë. Përkatësisht, qëllimi i ATOMI-t është identifikimi i hershëm i nxënësve me inteligjencë të jashtëzakonshme, me dhunti e talente, si dhe ofrimi i mundësive, kushteve, trajtimit, përkujdesjes dhe shkollimit të veçantë për këta nxënës, bazuar në potencialet e tyre intelektuale, dhuntinë, talentin, personalitetin, ambiciet, interesimet, motivacionin dhe kushtet e rrethanat reale socio-ekonomike të tyre. E gjithë kjo bëhet me qëllim që këta nxënës të kenë mundësi që ta zhvillojnë dhe realizojnë maksimalisht potencialin e tyre dhe kështu t'i kontribuojnë në radhë të parë zhvillimit të tyre personal dhe në të njëjtën kohë edhe interesit të gjithmbarshëm të vendit dhe shoqërisë.



## NLB Banka dhuron donacion për përmirësimin e kushteve të banimit në Institutin Special në Shtime

Me rritjen e rezultateve të NLB Banka rritet edhe përgjegjësia sociale e Bankës ndaj komunitetit ku vepron. Progresi i përgjithshëm në afarizmin e Bankës është shtytje dhe motiv shtesë për mbështetjen e projekteve humanitare për një jetë më të mirë. NLB Banka duke i parë kushtet e vështira të banorëve të Institutit Special në Shtime dhe nevojës për renovim dhe inventar në këtë Institutit ka dhënë donacion me qëllim të përmirësimit të kushteve të banimit. Me këtë donacion është blerë inventar për 67 banorë që banojnë në këtë Institut dhe është bërë renovim në shumë pjesë të tij. Në ceremoninë e përfundimit të renovimit të Institutit Special në Shtime të pranishëm ishin zyrtarë nga NLB banka, z.Vesel Makolli, Zv. Ministrës i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Rrahman Jakupi, Nënkyetar i Komunës së Shtimes, Xhemajl Dugolli, Drejtor i Institutit Special në Shtime si dhe përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, KFOR-it Turk, Drejtorive të Komunës së Shtimes dhe mediave. NLB Banka deri më tani ka



përkrahë financiarisht në formë donacioni renovimin e Spitalit të Pediatriisë, Shtëpisë së të moshuarve, ka ndihmuar fëmijë në nevojë si dhe ka marr pjesë edhe në shumë projekte të tjera humanitare. Kontributi i NLB Bankës do të vazhdojë edhe në të ardhmen në mbështetje të aktiviteteve dhe projekteve të rëndësishme ekonomike, humanitare, sociale e kulturore, të cilat kontribuojnë direkt në zhvillimin, lehtësimin dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës.

## Banka Ekonomike për të dytin vit radhazi në kuadër të përgjegjësive sociale ka përkrahur Ecjen Globale të mentorimit me moton 'Balanco për të mirë'

Banka Ekonomike për të dytin vit radhazi në kuadër të përgjegjësive sociale ka përkrahur Ecjen Globale të mentorimit me moton 'Balanco për të mirë' duke ju bashkuar iniciativës globale të Vital Voices e cila këtë vit organizohet në 62 shtete të botës me qëllim të fuqizimit të gruas. Aktiviteti ky i cili ndodh çdo vit në mbarë botën për festimin e Ditës Ndërkombëtare të gruas, ku mijëra gra e burra, vajza e djem nga e gjithë bota mblidhen në komunitetet e tyre për të marrë pjesë në shëtitje. Ky donacion është pjesë e përkushtimit të vazhdueshëm të Bankës Ekonomike për ngritjen e vetëdijesimit dhe përgjegjësive sociale të shoqërisë sonë.



## BPB për vitin e katërt radhazi përkrah shoqatën

### 'Aksioni për Nëna dhe Fëmijë' dhe ngjarjen 'Let's dance'

1 nëntor 2018, Prishtinë – BPB, për vitin e katërt radhazi, mbështet shoqatën 'Aksioni për Nëna dhe Fëmijë' dhe ngjarjen 'Let's dance', të organizuar me qëllim të mbledhjes së fondeve në përkrahje të nënave dhe fëmijëve në Kosovë. Kësaj here banka është përkrahësi kryesor i kësaj ngjarje. Është privilegj që kemi mundësinë me e ndihmu një aktivitet me një qëllim kaq fisnik. Nënata dhe fëmijët janë shtylla e secilës shoqëri, prandaj ne në BPB mundohemi të



bëjmë sa më shumë që mundemi për të përkrahur aktivitete të tilla' - tha z. Arton Celina, Kryeshef Ekzekutiv në BPB.

Aktiviteti i organizuar ka karakter argëtues dhe humanitar, dhe mbledh rreth vetës individë dhe institucione të vullnetit të mirë me qëllim që përmes argëtimit të mbledh fonde për projekte dhe aktivitete që ndihmojnë programet edukative, hulumtuese dhe avokuese të organizatës 'Aksioni për Nëna dhe Fëmijë'.

BPB do të vazhdojë të përkrahë aktivitete të përgjegjësive shoqërore, duke përkrahur kështu komunitetin në të cilin vepron.



## MKRS-ja nënshkruan memorandum bashkëpunimi me Bankën Kombëtare Tregtare

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur në takim Kryeshefin ekzekutiv të Bankës Kombëtare Tregtare, Suat Bakkal.

Gjatë këtij takimi u nënshkrua një memorandum bashkëpunimi mes MKRS-së dhe Bankës Kombëtare Tregtare.

Qëllimi i këtij Memorandumi është rritja e mundësisë së bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve rinore, ku do të realizohet një trajnim në 19 komuna të Kosovës gjatë këtij viti dhe në 19 komuna në vitin tjetër, lidhur me edukimin financiar, bëhet e ditur përmes një komunikate për media. Gashi tha se "kjo marrëveshje që u nënshkrua sot ka për qëllim trajnimin e të rinjve, i cili do t'ju mundësojë atyre të



zhvillojnë njohuritë në fushën e financave dhe pas përfundimit të këtij trajnimi ata do të jenë më të përgatitur për tregun e punës". Tutje, ai tha se kërkesa për mbajtjen e këtij trajnimi ka dalë nga vetë të rinjtë, sipas një

analize që është bërë në të gjithë Kosovën. "Është konstatuar që të rinjtë tanë kanë nevojë të mbajnë trajnime për edukimin financiar. Ne nuk do të ndalemi me kaq, në të ardhmen do të realizojmë edhe shumë trajnime të tjera, duke pasur parasysh që prioritet dhe synim i Ministrisë është që të rinjtë në Kosovë t'i avancojë dhe aftësojë për sfidat jetësore", ka thënë Gashi. Ndërkohë, Kryeshefi ekzekutiv i Bankës Kombëtare Tregtare, Suat Bakkal, falënderoi ministrin Gashi për mbështetjen dhe gatishmërinë e treguar dhe tha se Banka ka siguruar katër trajnerë që do të angazhohen maksimalisht, në mënyrë të rinjtë të përfitojnë sa më shumë që është e mundur gjatë pjesëmarrjes në këtë trajnim.



## Banka Kombëtare Tregtare, pjesë e fushatës "Bëhu Mik i Tokës" të organizuar nga Komuna e Prishtinës për nder të "Ditës Ndërkombëtare të Tokës"

Banka Kombëtare Tregtare ka mbështetur aktivitetin e Komunes së Prishtinës për nder të "Ditës Ndërkombëtare të Tokës" me moton "Bëhu Mik i Tokës" me datën 22 Prill 2019. Rreth tridhjetë punonjës të Bankës Kombëtare Tregtare, kanë dhënë kontributin e tyre vullnetar duke mbjel-



lur dhjetëra fidanë pranë shkollës fillore "Dardania" në Prishtinë. Banka Kombëtare Tregtare është e dedikuar që në vazhdimësi t'i përkrahë aktivitetet e tilla të organizuara nga Komunitatet e Kosovës, si dhe të kontribuojë në forma të ndryshme në mjedisin ku vepron.

## ProCredit Bank 19 vjet sponzor gjeneral i Gjysmë Maratonës Ndërkombëtare

Edhe këtë vit, për 19-tin vit me radhë, banka ProCredit mbështeti Gjysmë Maratonën Ndërkombëtare - Prishtina 2019 e cila mbodhi garues nga e gjithë bota. ProCredit është mbështetës tradicional i kësaj ngjarjeje të rëndësishme sportive në vend, e cila kontribuon në imazhin e sportit të Kosovës si dhe ndau çmimin për njërin nga kategoritë e maratonës.



# PUBLIKIMET E SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS


“The Kosovo Banker” është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Revista botohet dy herë në vit dhe ka për qëllim të informojë publikun lidhur me industrinë bankare në Republikën e Kosovës. Për më tepër informata, drejtohuni tek web faqja e Shoqatës së Bankave të Kosovës [www.bankassoc-kos.com](http://www.bankassoc-kos.com)



[www.bankassoc-kos.com](http://www.bankassoc-kos.com)

## Edicionet e The Kosovo Banker:





## QENDRA E TRAJNIMEVE NË SHOQATËN E BANKAVE TË KOSOVËS

Ofron trajnime të ndryshme për sektorin financiar të Kosovës duke përfshirë edhe këto fusha:

- > Menaxhimi rrezikut bankar
- > Pajtueshmëri dhe Parandalimin e Pastrimit të Parave
- > Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
- > Auditim dhe kontroll i brendshëm
- > Menaxhimi i Aseteve dhe Detyrimeve
- > Bankingu Digjital
- > Menaxhimi i sigurisë kibernetike dhe i informacionit
- > Vlerësimi i kreditë
- > Shitja e shërbimeve financiare
- > Financimi i tregtisë
- > Mbrojtja e të dhënave personale
- > Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- > Udhëheqje dhe menaxhim


### PARTNERËT:



Qendra për trajnime bankare në kuadër programit të saj të trajnimeve ofron edhe certifikime të njohura ndërkombëtare, uebinare dhe trajnime përmes kanaleve elektronike në fushën e industrisë bankare.

## REDUKTIMI I TRANSAKSIONEVE ME PARA TË GATSHME

A E KENI DITUR SE PËRDORIMI I KARTELËS BANKARE  
SJELLË SHUMË BENEFITE



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

038 246 171  
[www.bankassoc-kos.com](http://www.bankassoc-kos.com)